



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 27 (827779)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 8 Korrik 2022

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit dhe marrjes së detyrës së komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë (SACEUR), Mons, Belgjikë. Gjeneral Tod Wolters (Forca Ajrore, SHBA) i dorëzoi detyrën gjeneral Christofer Cavoli-t. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi maksi-

malisht leadershipin e gjeneral Wolters për udhëheqjen, drejtimin dhe komandimin me sukses të Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet në përbushjen e misionit të Aleancës. Stoltenberg theksoi se gjeneral Wolters ka meritën e parandalimit që kriza shëndetësore e krijuar nga COVID - 19, të transformohej në krizë sigurie si dhe reagimin me shpejtësi dhe forcë ndaj agresionit brutal të Rusisë ndaj Ukrainës duke forcuar krahun lindor të Aleancës. Duke u uruar

mirëseardhjen, Stoltenberg u shpreh se gjeneral Cavoli do shërbejë në NATO me të njëjtin leadership dhe përkushtim që ai ka treguar gjatë të gjithë karrierës së tij. Gjeneral Cavoli merr komandën në një kohë të rëndësishme për Aleancën, e cila shënohet me rritjen e konkurrencës strategjike dhe rikthimit të luftës brutale në Europë. Sekretari i Përgjithshëm u shpreh se gjeneral Cavoli me ekipin e tij në SHAPE do vijoje të përbushë me sukses misionin... >> faqe 2



Aktivizohet në Shqipëri Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-ve

Ministri Peleshi: Shqipëria, pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës, tashmë me kontribut edhe në Bullgari



79 vjet nga Masakra e Borovës/ Ministria e Mbrojtjes u jep statusin "Dëshmor i Atdheut" 107 civilëve të rënë

Në 79-vjetorin e Masakrës së Borovës, Ministria e Mbrojtjes u akordoi statusin "Dëshmor i Atdheut", 107 civilëve të rënë. Në aktivitetin e organizuar në Kolonjë ishte i pranishëm ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përkujtoi së bashku me familjarët këtë ngjarje tronditëse të historisë së vendit tonë. Kryetari i Bashkisë së Kolonjës, Erion Isai falënderoi ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi për firmosjen e këtij akti, që ka qenë një përpjekje disavjeçare... >> faqe 2



Forca Ajrore: 91 vite, krijimi i Armës së Mbrojtjes Kundërajrore

Në këtë fillim korriku, Komanda e Forcës Ajrore, kremtoi 91-vjetorin e krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore (MKA) me një ceremoni të thjeshtë, me praninë e komandantit të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefit të Shtabit, kolonel Arben Cenolli, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, ish-komandantë të Mbrojtjes Kundërajrore, veteranë të kësaj arme në vite si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore. Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Pulaj u uroi mirëseardhjen të ftuarve, të cilët i cilësoi dëshmitarë të rrugës së vështirë nëpër të cilën ka... >> faqe 4



SHSHFD merr pjesë në zhvillimin e bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë

U zhvilluan në Athinë bisedimet e Shtabit (Staff Talks) me Forcën Detare të Greqisë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi rreth fushave të bashkëpunimit dypalësh midis dy Forcave Detare për vitet 2023 - 2024. Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i Rangut I Sabri Gjinollari, shefi i Degës së Planifikimit/Programimit kapiten i Rangut II Erjet Huqi dhe shefi i Zyrës së Komandantit, kapiten i Rangut III Blendi Melishte. Gjatë zhvillimit të bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë u diskutuan dhe dakordësuan zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta detare dhe planëzimi... >> faqe 4



79 vjet nga Masakra e Borovës

Ministria e Mbrojtjes u jep statusin
“Dëshmor i Atdheut” 107 civilëve të rënë

Në 79-vjetorin e Masakrës së Borovës, Ministria e Mbrojtjes u akordoi statusin “Dëshmor i Atdheut”, 107 civilëve të rënë.

Në aktivitetin e organizuar në Kolonjë ishte i pranishëm ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përkujtoi së bashku me familjarët këtë ngjarje tronditëse të historisë së vendit tonë.

Kryetari i Bashkisë së Kolonjës, Erion Isai falënderoi ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi për firmosjen e këtij akti, që ka qenë një përpjekje disavjeçare, ndërsa u shpreh gatishmëria e plotë nga ana e pushtetit lokal dhe atij qendror për ristrukturimin e muzeut.

Më 6 Korrik 1943, formacionet partizane goditën forcat naziste tek Ura e Barmashit. Ushtria gjermane si hakmarrje dogji Borovën, ku brenda një dite u vranë dhe masakruan 107 civilë.



SACEUR

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në ceremoninë e
ndërrimit të komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit dhe marrjes së detyrës së komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë (SACEUR), Mons, Belgjikë. Gjeneral Tod Wolters (Forca Ajrore, SHBA) i dorëzoi detyrën gjeneral Christofer Cavoli-t.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi maksimalisht lidhshëpin e gjeneral Wolters për udhëheqjen, drejtimin dhe komandimin me sukses të Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet në përmbushjen e misionit të Aleancës. Stoltenberg theksoi se gjeneral Wolters ka meritën e parandalimit që kriza shëndetësore e krijuar nga COVID - 19, të transformohej në krizë sigurie si dhe reagimin me shpejtësi dhe forcë ndaj agresionit brutal të Rusisë ndaj Ukrainës duke forcuar krahun lindor të Aleancës. Duke i uruar mirëseardhjen, Stoltenberg u shpreh se gjeneral Cavoli do shërbejë në NATO me të njëjtin lidhshëpin dhe përkushtim që ai ka treguar gjatë të gjithë karrierës së tij. Gjeneral Cavoli merr komandën në një kohë të rëndësishme për Aleancën, e cila shënohet me rritjen e konkurrencës strategjike dhe rikthimit të luftës brutale në Europë. Sekretari i Përgjithshëm u shpreh se gjeneral Cavoli me ekipin e



tij në SHAPE do vijojë të përmbushë me sukses misionin e aleancës për mbrojtjen e hapësirës euro-atlantike.

Gjeneralmajor Shehu falënderoi gjeneralin Wolters për përmbushjen me sukses të detyrës, si dhe i uroi

mirëseardhjen gjeneral Cavoli-t në detyrën e rëndësishme të Komandantit të Komandës Strategjike të Operacioneve të NATO-s. Gjeneralmajor Shehu në emër të FARSH e garantoj gjeneral Cavoli-n për forcim të bashkëpunimit,



mbështetje dhe kontribut kudo dhe kurdo që aleanca do të ketë nevojë.

Komanda Supreme e Aleatëve në Europë (SACEUR) është përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e të gjitha operacioneve të NATO-s.

Gjenerali Cavoli është komandanti i njëzetë Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR). I pari që zuri postin ishte gjeneral Dwight D. Eisenhower, më pas presidenti i 34-t i Shteteve të Bashkuara.

Aktivizohet në Shqipëri Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-ve

Ministri Peleshi: Shqipëria, pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës, tashmë me kontribut edhe në Bullgari

Aktivizohet në Shqipëri Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SFAB), një ekip i cili do të mbështesë dhe këshillojë Batalionin e Dytë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në prani edhe të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi dhe ambasadores së SHBA-ve në Shqipëri, znj. Yuri Kim, u theksua rëndësia e ndërveprueshmërisë mes aleatëve të NATO-s në një terren të ri për sigurinë botërore. Në fjalën e tij, ministri Peleshi vlerësoi mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë për Forcat e Armatosura. “Ky grup-batalion është objektivi ynë kryesor në NATO dhe jemi duke punuar intensivisht për të bërë të mundur realizimin e të gjitha detyrimeve në këtë kuadër dhe padyshim asistencë e ekipit amerikan është e një rëndësie të veçantë. Jam i bindur që puna juaj do të japë frytet e saj dhe do të kurorëzohet me certifikimin e suksesshëm që kjo strukturë do t’i nënshtrohet gjatë muajit shtator të këtij viti”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Duke theksuar vendimet tejet të rëndësishme që u morën në Samitin e NATO-s në Madrid si dhe miratimin e Konceptit të ri Strategjik të Aleancës, ministri Peleshi garantoj forcimin e angazhimit të Shqipërisë përkrah aleatëve të saj ushtarakë. “Shqipëria, jo vetëm që do të vijojë të jetë pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës me prezencën tonë në Letoni, por do të shtojë kontributin edhe në Bullgari, në kuadër të grup-batalioneve të reja, që do të krijohen në disa prej vendeve anëtare të Aleancës. Ne do të vijojmë të përmbushim me seriozitet dhe profesionalizëm detyrimet në Aleancë dhe detyra juaj, të nderuar ushtarakë, është të shfrytëzoni në maksimum këtë mundësi që ju jepet për të rritur dhe më tej standardet operacionale në mënyrë që të jeni të ndërveprueshëm me homologët tuaj”, - theksoi ministri Peleshi.

Në fjalën e saj, ambasadorja amerikane Yuri Kim e vlerësoi aktivizimin e Brigadës së Forcave të Sigurisë dhe të ndihmës së ushtrisë së SHBA-ve si një hap të rëndësishëm për të çuar në lartësi të reja marrëdhëniet SHBA-Shqipëri. “Është e rëndësishme që ju të përmbushni të gjitha objektivat tuaja që u diskutuan edhe në Samitin e NATO-s. Bota ka ndryshuar, ka sfida të reja, të cilat duhet të përmbushen. Çdo aleat duhet të jetë i gatshëm, i përgatitur dhe për këtë arsye jemi të kënaqur për forcën e sotme në mënyrë që të jemi të gatshëm, që NATO të jetë e gatshme. Nën drejtimin e



ministrit Peleshi dhe gjeneral brigade Kingjit forcat shqiptare vazhdojnë të përmirësohen përmes modernizimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe ndryshimeve strukturore që do të luajnë një rol të rëndësishëm, jo vetëm për Shqipërinë, po për sigurinë rajonale dhe globale. Ndërveprueshmëria e aleatëve të NATO-s është vendimtare”, - vlerësoi ambasadorja Kim.

Në ceremoni morën pjesë edhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Manushaqe Shehu dhe komandanti i Forcës Tokësore Arben Kingji. Aktivizimi i ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-ve në Shqipëri vjen pas aktivizimit në vendin tonë edhe të Shtabit të Përpëruar të Forcave Speciale amerikane në Europë.


Urimi

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi uron gjeneral Christopher Cavoli-n, për marrjen e mandatit si Komandant Suprem i aleatëve të NATO-s në Europë (SA-CEUR). Ashtu siç deklaroi edhe Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, Gjeneral Cavoli e merr detyrën në një kohë që Aleanca vendosi të përforcojë praninë në Europën Lindore dhe të zbatojë një model të ri force në muajt e ardhshëm.



Ministri Peleshi: Presim të vijojmë me kënaqësi dhe angazhim maksimal bashkëpunimin tonë





Gjatë zhvillimit të bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë u diskutuan dhe dakordësuan zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta detare dhe planëzimi operacional.

Forca **DETARE**

Shefi i Shtabit të Forcës Detare merr pjesë në zhvillimin e bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë

Uzhvilluan në Athinë bisedimet e Shtabit (Staff Talks) me Forcën Detare të Greqisë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi rreth fushave të bashkëpunimit dypalësh midis dy Forcave Detare për vitet 2023 - 2024.

Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i Rangut I Sabri Gjinollari, shefi i Degës së Planifikimit/Programimit kapiten i Rangut II Erjet Huqi dhe shefi i Zyrës së Komandantit, kapiten i Rangut III Blendi Melishte.

Gjatë zhvillimit të bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë u diskutuan dhe dakordësuan zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta detare dhe planëzimi operacional, pjesëmarrja e përvitshme në stërvitjen e organizuar nga Forcat Detare të Greqisë 'NIIRIS', vizita të ndërsjella portuale, trajnimi i personelit të Forcës Detare të Shqipërisë në qendrat e trajnimit të FD të Greqisë, bashkëpunimi në iniciativat shumë-



palëshe, bashkëpunimi në projektet e modernizimit, imbarkimi i oficerëve të FD të Shqipërisë në anijet e Forcës Detare të Greqisë gjatë dislokimit në operacionin e NATO-s FOCOPS etj.

Në nder të vizitës së delegacionit të Forcës Detare në Greqi, zëvendëskomandanti i Forcës Detare greke mirëpriti

kapiten i Rangut I Sabri Gjinollari në një takim kortezie.

Në përfundim të bisedimeve të Shtabit, u shpreh interesi i përbashkët për rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet identifikimit të fushave të reja dhe të përmirësohet më tej bashkëpunimi dypalësh.



TAKIMI

Kundëradmiral Adnand Agastra pret përfaqësuesit e zyrës së drogës dhe kriminit të Kombeve të Bashkuara

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një takim me përfaqësuesit e zyrës së drogës dhe kriminit të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me Forcën Detare, detyrat që kryen për



zbatimin e ligjit në det si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e ligjit në det. Nga përfaqësuesit e zyrës u kërkua dhënia e asistencës nga Forca Detare/Roja Bregdetare për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të institucioneve tona me qëllim eksplorimin e një qasje të tillë në vendet e Afrikës së Veriut, si model i suksesshëm ndërinstitucional për zbatimin e ligjit në det.


Në përfundim të takimit përfaqësuesit e zyrës së drogës dhe kriminit të Kombeve të Bashkuara, shprehën mendimin për bashkëpunimin e vazhdueshëm si dhe projektet më të afërta që do të jetë shkëmbimi i eksperiencës pozitive për zbatimin e ligjit në det.

Përfundon stërvitja “Imponimi 2022”, koordinim për kapjen e anijeve që shkelin ligjin

Efektivë të Forcës Detare, Rojës Bregdetare, Repartit të Operacioneve Speciale të Forcës Tokësore, Policisë Kufitare dhe Kapitanerisë së Portit të Durrësit zhvilluan stërvitjen e përbashkët “Imponimi 2022”.

Kjo stërvitje ka si qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e operacioneve të përbashkëta për ndalimin, shoqërimin dhe bllokimin e anijeve që shkelin ligjin në det. Të ftuar në ditën e hapur me rastin e përfundimit të saj ishin zëvendësministrija e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dima si dhe përfaqësues të tjerë të pushtetit vendor dhe institucioneve ligjzbatuese në det.





25 efektivë të batalionit të Parë të Këmbësisë, morën pjesë në operacionin për fikjen e zjarrit në malin e Jushit, Torovicë, ku situata është nën kontroll.



FA dhe Emergjencat Civile në mbrojtje të komunitetit dhe pasurisë natyrore

67 efektivë dhe 7 mjete nga Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile dhe Forcës Tokësore u angazhuan për shuarjen e vatrës së zjarrit në malin Tole, në zonën e Krastës, në Krujë. Kjo vatrë e fikur një ditë më parë, pati aktivizime të vatrave të reja. Në zonë ndodheshin edhe forca të Agjencisë së Mbrojtjes Civile, zjarrfikësit nga Durrësi dhe Kruja si dhe punonjës të administratës vendore dhe vullnetarë.



Në Forcën Tokësore po zhvillohet stërvitja planëzuese e Grup Batalionit të Këmbësisë së Lehtë (GBKL) "Biza 22-01". Qëllimi i kësaj stërvitjeje është aftësimi i shtabit, në aplikimin e Procesit të Vendimmarrjes Ushtarake.



Efektivët e Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore, në bashkëpunim me Forcën Detare, marrin pjesë në stërvitjen e koduar "Imponimi-22" në kuadër të operacioneve kundër shkelësve të ligjit në det.



Ekspertët amerikanë trajnojnë personelin e Grup Batalionit të Këmbësisë së Lehtë, mbi përdorimin dhe montimin në mjete të radiove "Type One".



APLIKONI TANI

Për t'iu bashkuar ekipit të teknikëve në strukturën e qendrës së riparimit në Forcën Ajrore. Një mundësi fantastike punësimi dhe avancimi karriere për të gjithë profesionistët që kanë dëshirë dhe vizion për t'u bërë teknikë sipas standardeve të NATO-s.

Për kushtet, kriteret dhe formularin e aplikimit klikoni në linkun e mëposhtëm:

Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura!

<https://rb.gq/mrguvq>



Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes AFA-së dhe Universitetit "Luarasi"

Akademia e Forcave të Armatosura po vijon të shtojë vlerat e saj, si i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë për Mbrojtjen dhe Sigurinë në vend.

AFA dhe Universiteti "Luaras" në Tiranë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, e cila do të mundësojë shkëmbim personeli akademik dhe studentësh në lëndët me interes të përbashkët, bashkëpunim në fushën e kurrikulave, konferenca e praktika të përbashkëta dhe studime të thelluara në fusha si Siguria Kombëtare, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Siguria Kibernetike, etj.

Marrëveshja u nënshkrua nga dy Rectorët Profesor Dr. Ethem Ruka dhe gjeneral brigade Dr. Albert Mullai.



AFA



Studentët e Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri (KPO), po zhvillojnë me sukses stërvitjen 72-orëshe me dalje në terren. Ata, nën drejtimin e komandantit të fushimit, major Alban Gega, ngritën kampingun në Bazën e Pashalimanit dhe po vijnë programin intensiv për familjarizimin me të gjithë elementët e nevojshëm të një fushimi.



Gjeneral brigade Albert Mullai: Cilësia e përgatitjes së oficerëve në këtë kurs, hallkë kyçe për karrierën e oficerit

Në ambientet e auditoriumit të MM, u zhvillua ceremonia e diplomimit të kursantëve të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Flamur Hadushi, atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës i akredituar në vendin tonë, nënkolonel Enver Hoti, drejtorë të Akademisë së Forcave të Armatosura, drejtues departamentesh, pedagogë dhe stafi mbështetës i AFA-së. Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, në fjalën e hapjes, duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit, theksoi rëndësinë e këtij kursi, cilësinë e përgatitjes së oficerëve në këtë kurs si një hallkë kyçe në karrierën e oficerit pasi kalon nga niveli bazik në nivelin operativ e strategjik në punën në shtabe po edhe në drejtim të komandim kontrollit. Më tej ai theksoi duke iu drejtuar oficerëve të sapo diplomuar: "Kursi që sapo përfunduar përbën një ngjarje të shënuar në karrierën tuaj ushtarake, pasi ju ka pajisur juve me njohuritë e nevojshme për të punuar në nivel shtabi brigade, të aftë për të planëzuar operacione



luftarake në një mjedis kompleks operacional, por mbi të gjitha ai përbën një moment të rëndësishëm në kuptimin e forcimit të kohezionit mes drejtuesve të ardhshëm të FA-së". Në këtë ceremoni



u diplomuan 50 oficerë të Forcave të Armatosura dhe 14 oficerë nga FSK. Në përfundim të kësaj ceremonie u zhvillua ceremonia e ndarjes së diplomave për të gjithë oficerët e sapo diplomuar.



Forca Ajrore: 91 vite, krijimi i Armës së Mbrojtjes Kundërajrore

Në këtë fillim korriku, Komanda e Forcës Ajrore, kremtoi 91-vjetorin e krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore (MKA) me një ceremoni të thjeshtë, me praninë e komandantit të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefit të Shtabit, kolonel Arben Cenolli, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, ish-komandantë të Mbrojtjes Kundërajrore, veteranë të kësaj arme në vite si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore. Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Pulaj uroi mirëseardhjen të ftuarve, të cilët i cilësoi dëshmitarë të rrugës së vështirë nëpër të cilën ka kaluar arma e artillerisë kundërajrore, duke përshkruar disa prej momenteve më të rëndësishme historike të kësaj arme. Në vijim, gjeneral Pulaj kujtoi me respekt komandantin e parë të Mbrojtjes Kundërajrore, gjeneral Gjini Markun si dhe komandantë të tjerë të MKA, si Sotir Filto, Arif Hasko, Todi Naço, Bejto Isufi, Kiço Janku, Naum Gjini, Pali Prifti, Ylli Dimraj. Në përfundim të fjalës së tij, komandanti i Forcës Ajrore adresoi një nderim për dëshmorët e kësaj arme dhe mirënjohje për familjet e tyre, si dhe përmendi kontributin aktual të Forcës Ajrore në strukturat ajrore operacionale dhe taktike të NATO-s, si dhe me asete moderne të vëzhgimit ajror dhe kompletimit me elementë të mbrojtjes ajrore të bazuara në tokë, në vitet në vazhdim. Në emër të të ftuarve, fjalën përshëndetëse e mbajti ish-komandanti i Regjimentit të MKA-së z. Gëzim Punavia.

Në fund të ceremonisë, u shpërndanë certifikata mirënjohje për ish-ushtarakët e shquar të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore në vite.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Bashkimi European nuk është thjeshtë një bashkim ekonomik e politik, por është para së gjithash një bashkim vlerash, ky është parimi bazë mbi të cilin mori formë ideja e një tregu të përbashkët mes vendeve europiane, duke i dhënë jetë në vitin e largët 1951 Komunitetit Ekonomik European, të përbërë në atë kohë nga vetëm gjashtë vende: Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Sot Bashkimi European përbëhet nga 28 vende, por vizioni mbi të cilin ai ngrihet është gjithnjë ai i fillimeve: vizioni i përbashkët i etërve themelues për një Europë të Bashkuar, të cilët gjykuan se e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund konflikteve dhe për të siguruar një paqe të qëndrueshme në kontinentin që sapo kishte dalë nga një luftë e përgjakshme, që të krijohej një sistem vendimarrjeje dhe bashkëpunimi i përbashkët, i cili do të mund të siguronte zhvillim e përparim ekonomik e social, të ngritur mbi parimin e solidaritetit dhe të kohezionit social.

Në fakt, pavarësisht ndryshimeve që mund të ekzistojnë mes vendeve apo rajoneve të ndryshme nga të cilat përbëhet sot Bashkimi European, ajo që i dallon ato është objektivi për një organizim social që të garantojë një shoqëri sa më të drejtë, që t'iu sigurojë qytetarëve respektimin e të drejtave të tyre themelore, mbrojtjen sociale, si dhe që të sigurojë dialogun social, si faktorin rregullues të ekuilibrave sociale në shoqëri. E gjithë kjo njihet me termin 'Modeli Social European'.

Ajo që mund të thuhet këtu, është se në vitet '90 shqiptarët dolën nga komunizmi dhe hynë në rrugën e ndryshimeve, duke u përballur me gjithë pasojat dramatike të së shkuarës së tyre. Komunizmi autarkik shqiptar kishte lenë pas një katastrofë të vërtetë ekonomike. Shqipërisë së viteve 1990 i mungonin shumë nga ato parakushte që duhet të plotësojë një vend e një popull që të jetë i aftë të adaptojë modelin perëndimor të modernitetit. I mungonte, para së gjithash, ai minimum zhvillimi ekonomik modern që nevojitet për të ngritur një sistem demokratik liberal të mbështetur në një ekonomi të lirë të tregut. Shqipëria e fillimit të viteve '90 ishte jo vetëm vendi më i prapambetur i Europës, por dhe një vend ku mungonte një klasë e mesme e konsoliduar qytetare, e cila siç dihet, përbën kolonën mbi të cilën mbështetet stabiliteti shoqëror i një vendi. Mungonte një traditë e vërtetë dhe e qenësishme borgjeze e qytetare. Mungonin institucionet e pavarura, të cilat do të mund të siguronin atë nivel të nevojshëm stabiliteti shoqëror për një kalim deri diku të butë nga një sistem politik tek tjetri. Mungonte një elitë e aftë për të drejtuar një vend kaq të varfër e të prapambetur në rrugën e modernizimit drejt një demokracie liberale.

Siç dihet, elita politike dhe intelektuale që pas vitit 1991 mori në duar drejtimin e vendit, ishte e dalë thuajse tërësisht nga elita e kohës së komunizmit, çka do të thotë se në përgjithësi, mënyra e saj e sjelljes dhe e të menduarit mbetej kryesisht e kushtëzuar prej së shkuarës, duke pasqyruar drejtpërsëdrejti përvojën e tyre të mëparshme. S'duhet harruar po ashtu, se në vitin 1990 Shqipëria që

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se si popull kemi rrënjë mijëravjeçare dhe nëpër etapat e jetës jemi zhvilluar, evoluar e përparuar duke u rrahur nga rryma të ndryshme qofshin ato pushtuesish, okupatorësh, uzurpuesish, luftërash, fatkeqësish etj. Sot po vihem përballë një zgjedhjeje të vështirë të bëhemi "europianë" me mendësi dhe parime, me vlera dhe ndjesi.

Europa e vogël në brigjet e Jonit



një vend kryesisht rural, me përqindjen më të lartë të popullsisë fshatare në Europë (zyrtarisht, popullsia që jetonte në fshat në vitin 1990, llogaritej 70%). Në të vërtetë, ky fakt shpjegon dhe përse në Shqipëri ndryshimi i sistemit s'që thjeshtë një shndërrim i natyrës politike e ekonomike nga diktatura në kapitalizëm e demokraci, nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur, nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut, siç ndodhi në shumicën e vendeve të tjera ish-komuniste të Europës. Në shoqërinë e brishtë shqiptare, të tronditur nga ndryshimet tepër të shpejta e rrënjësore, solli anarkinë dhe një krizë të rëndë morale, një prishje të gjithë sistemit të vlerave. Pjellë e këtij deformimi ishin dhe piramidat financiare dhe drama që ato sollën në mes të viteve 1990. Rezultati është kriminalizimi i segmenteve të rëndësishëm të shoqërisë dhe bashkëjetesa e politikës me krimin. Rezultat është simbioza e një pjese të madhe të administratës qendrore e lokale me një shtresë të sapokrijuar pasanikësh të rinj arrogantë, e pa shumë skrupuj. Përfundimi që shkërmoqja graduale e autoritetit të shtetit dhe, më pas, e vetë ngrehinës së tij dhe humbja e shpresës për shqiptarin e thjeshtë e të çoroditur se gjërat një ditë mund të ndreqen. Pasoja më e dukshme e dramatike, fakti që mbi 30% e shqiptarëve duke pasur më besim se gjërat mund të ndryshonin zgjedhën rrugën e emigracionit, duke u larguar nga vendi e shpërndarë nëpër botë.

Europa është menduar të jetë jo vetëm kontinenti i shumë vendeve (në një vend dhe në një hapësirë), por më tepër një komunitet i komunitetit të njerëzve dhe popujve me prejardhje të ndryshme por histori të përbashkët, vlerat e përbashkëta dhe perspektivave të përbashkëta të zhvillimit politik, ekonomik, social dhe kulturor. Europa është një mënyrë e të menduarit dhe të vepruarit. Qytetaria Europiane si një marrëdhënie qytetar-qytetar nënkupton një marrëdhënie jo abstrakte dhe as statike por një marrëdhënie që mund të jetohet, bazuar në një praktikë e një kod moral, një kod që ka shqetësim për të drejtat dhe interesat e të tjerëve,

që e bën shoqërinë civile dhe arritet e demokracisë 'civile' më të rëndësishme në zhvillimin e demokracisë politike.

Ajo është një proces i bashkëpunimit paqësor mes kulturave të ndryshme, mes individëve me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, kombëtare dhe politike, midis individëve dhe grupeve shoqërore, midis individëve dhe shoqërisë, mes grupeve sociale, mes të gjithë këtyre aktorëve dhe institucioneve europiane në BE.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se si popull kemi rrënjë mijëravjeçare dhe nëpër etapat e jetës jemi zhvilluar, evoluar e përparuar duke u rrahur nga rryma të ndryshme qofshin ato pushtuesish, okupatorësh, uzurpuesish, luftërash, fatkeqësish etj. Sot po vihem përballë një zgjedhjeje të vështirë të bëhemi "europianë" me mendësi dhe parime, me vlera dhe ndjesi.

Por a jemi ne "europianët" që i duhen familjes së madhe?

Të lodhur nga kjo pritje e stërzgatur, shqiptarët kërkojnë të dinë më shumë për rrugën dhe për Europën. Ky ndërgjegjësim do të luante rol pozitiv në plotësimin e detyrave dhe në kërkimin e llogarisë, por dhe vetë qytetarët në këtë proces vetëdijësimi, do të "europianizohen" në mendësinë dhe sjelljen e tyre politike e shoqërore.

Nuk besoj se ndonjë nga ata që në dhjetor të vitit '90 brohoritën: "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" do të mendonte në atë kohë, se edhe sot, ende do të ishim shumë larg të qenit qytetarë të Europës së Bashkuar.

BE, dashuri apo domosdoshmëri mes palësh?!

Pavarësisht se Shqipëria është një vend i vogël dhe i varfër mund të ofrojë një sërë përfitimesh për BE-në, të tilla si në fushën e turizmit, pasi vendi gëzon një pozitë të favorshme gjeografike, në fushën kulturore, ku Shqipëria ka një pasuri të larmishme të trashëgimisë kulturore, disa prej tyre të mbrojtura nga UNESCO. Gjithashtu Shqipëria, duke qenë se është një vend me moshë mesatare të re, ofron mundësi punësimi për kompanitë apo investitorët e huaj. Anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në

NATO, më 2 prill 2009, e ka bërë Shqipërinë një nga partnerët më të besueshëm të Europës Perëndimore në rajonin e trazuar dhe të ndarë të Ballkanit. Pra siç shihet ky vend i vogël ballkanik është kthyer në një faktor pozitiv, në fushën e sigurisë dhe të bashkëpunimit bilateral apo multilateral në fushën ushtarake, jo vetëm në Ballkan por edhe në arenën ndërkombëtare. Por Shqipëria ka një cilësi të veçantë për t'u krenuar në botë, e cila është toleranca dhe harmonia midis komuniteteve fetare në vendin tonë, ku shumica e popullsisë janë myslimanë.

Turizmi zë një vend tepër të rëndësishëm në të ardhurat vjetore të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 Shqipëria u rendit si një ndër destinacionet kryesore turistike në botë për t'u vizituar nga prestigjiozja "Lonely Planet".

Industria e turizmit përqendrohet kryesisht përgjatë bregdetit Adriatik dhe Jon, ku vlen të përmenden plazhet në të ashtuquajturën Riviera Shqiptare. Natyra i ka falur Shqipërisë një faunë dhe florë të larmishme ku çdo vit e vizitojnë turistë të huaj kryesisht nga Europa Lindore, si nga Polonia dhe Republika Çeke.

Ekonomia shqiptare është kryesisht një ekonomi bujqësore, si një ndër burimet kryesore të punësimit dhe të të ardhurave vjetore (rreth 20% të GDP-së), kryesisht prej financimeve të investitorëve të huaj, duke qenë se pjesa më e madhe e popullsisë është e vendosur në zonat rurale. Pra fusha e bujqësisë është një tjetër sektor që zë një vend mjaft të rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Një bujqësi e zhvilluar do të thotë një Shqipëri konkurruese në Europë me anë të produkteve të saj, të cilat janë në përmbushje të plotë të të gjithë standardeve europiane, për sa i përket sigurisë si të produktit ashtu edhe të konsumatorit.

Shqipëria është një nga vendet më të vjetra në Europë, ku shqipja është një nga gjuhët më të veçanta dhe më të vjetra të familjes indo-europiane. Gjithashtu Shqipëria ka një numër të madh pasurish kulturore dhe monumentesh të kulturës të epokave të ndryshme

të tilla si amfiteatro, mozaikë, kisha, kështjella dhe kala, qytete të vjetra, disa prej të cilave të shpallura monumente kulture të trashëgimisë botërore dhe të mbrojtura nga UNESCO.

Që nga nënshkrimi i marrëveshjes të Tregtisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit European, në vitin 1992, dhe deri në vitet e fundit, Shqipëria është kthyer në një faktor pozitiv stabilizues në rajonin e trazuar të Ballkanit dhe ka treguar se mund të jetë një aleat tepër i rëndësishëm për partnerët ndërkombëtarë. Gjithashtu Shqipëria ofron një siguri juridike dhe fiskale për çdo investitor të huaj që ka dëshirë dhe shpreh interesin për të. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet europiane e ka lehtësuar mjaft procedurën burokratike të politikës fiskale dhe financiare.

Pavarësisht rezultateve të censurimit të fundit të kryer në Shqipëri, ku 58.79% e popullsisë i përkisnin besimit mysliman, duke e bërë komunitetin më të madh fetar në vendin tone, Shqipëria nuk është përfshirë kurrë nga konflikte me sfond fetar. Arsyeja mund të gjendet në frazën e famshme të rilindësit Vaso Pasha se: "Feja e Shqiptarit është Shqiptaria". Pra Shqiptaria nuk është gjë tjetër veçse një lloj feje e re patriotike ku përcaktohet identiteti kombëtar i shqiptarëve. Një arsye tjetër lidhet me faktin se kur Shqipëria u pushtua nga Perandoria Osmane, ku edhe pse pjesa më e madhe e shqiptarëve u konvertuan në fenë e re të pushtuesit, atë myslimane, ata nuk e harruan kurrë faktin se të parët e tyre i përkisnin fesë së krishterë dhe me kalimin e kohës kjo u kthye në një farë respekti. Këtë e përforcon më tepër fakti se midis shqiptarëve është më se normale martesat ndërmjet feve të ndryshme. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte i vetmi vend në të cilën hebrenjtë nuk u persekutuan por madje u strehuan, pasi shqiptarët e kishin si traditë ta respektonin mikun. Në kohën kur Europa u mbërthe nga kriza financiare më e madhe që nga krijimi i saj, Shqipëria ishte një ndër të paktat vende, të cilat nuk u prekën aspak apo patën efekt më të kufizuar. Tregu shqiptar gjatë dy dekadave të fundit, ka pësuar një sërë ndryshimesh që janë reflektuar në jetën e përditshme të qytetarëve shqiptarë.

Ky vend i vogël buzë brigjeve të Jonit, i lashtë sa njerëzimi mbi tokë. Një vend gjeostrategjik, me resurse si të pak vendeve rreth tij, pret të hyjë tashmë pa trokitur në shtëpinë e tij europiane, ku qytetarët shqiptarë të kenë të drejta të barabarta si gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes së madhe. Shqiptarët e kanë treguar në shekuj se me mendjet e tyre të ndritura dhe punën e palodhur kanë vënë nga një gur themeli pikërisht në këtë Europë që sot na shikon me skepticizëm të pabazë.

GJENERAL CHRISTOPHER CAVOLI, KOMANDANTI I RI SUPREM I ALEATËVE NË EUROPE

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Gjenerali i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Christopher Cavoli mori komandën e Komandës Aleate të Operacioneve në një ceremoni në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë në Mons, Belgjikë më 4 korrik 2022. Gjeneral Cavoli pason gjeneralin Tod Wolters të Forcave Ajrore të SHBA-së, i cili është në këtë detyrë që nga viti 2019. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg kryesoi ceremoninë. Ai përgëzoi gjeneralin Wolters për përkushtimin e tij vetëmohues ndaj Aleancës, përfshirë punën e tij për t'iu përgjigjur pandemisë COVID, tranzicionin e Misionit të Mbështetjes së Vendosur në Afganistan dhe përgjigjen me shpejtësi dhe forcë ndaj pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. Ai më tej falënderoi gjeneralin Wolters për udhëheqjen e zhvillimit dhe ekzekutimit të planeve të mbrojtjes së NATO-s të një lloji krejtësisht të ri, që hapi rrugën për vendime transformuese në Samitin e Madridit. “Ti ishe thjesht lideri i duhur, në postin e duhur, në kohën e duhur”, - tha Stoltenberg. Si mirënjohje për shërbimin e shquar të gjeneralit Wolters për Aleancën, Sekretari i Përgjithshëm i akordoi atij Medaljen e Shërbimit të Merituar të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm i uroi mirëseardhjen gjeneralit Cavoli, duke vënë në dukje se karriera e tij ushtarake 35-vjeçare ka qenë e shtrirë në të gjithë globin, nga Bosnja në Irak, Afganistan dhe Uashington, prania e SHBA-së në Europë në dekada, me mbi 100 000 trupa. “Ju bashkoheni me ne në një pikë kthese për sigurinë transatlantike, e shënuar nga konkurrenca strategjike në rritje dhe kthimi i konfliktit brutal në Europë, - tha Stoltenberg. - E di që do të vazhdoni t'i shërbeni NATO-s me të njëjtin lidhshmëri dhe përkushtim që keni treguar gjithmonë.”

Komanda Aleate e Operacioneve është përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e të gjitha operacioneve të NATO-s. Gjeneral Cavoli është Komandanti Suprem i njëzetë i Aleatëve në Europë (SACEUR). I pari që mori këtë detyrë ishte gjenerali Dwight D. Eisenhower, që më pas do të bëhej Presidenti i 34-të i Shteteve të Bashkuara.

“Tod Wolters, përmbushi detyrën fisnike me nder dhe dallim”

Ceremonia për të nderuar dy udhëheqës të shquar ushtarakë, gjeneralin Tod Wolters, nga Forca Ajrore e Shteteve të Bashkuara dhe gjeneralin Christopher Cavoli, nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara, Komandanti aktual dhe ai i ardhshëm Suprem i Aleatëve në Europë, SACEUR, u kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

“Të quhesh SACEUR do të thotë t'u shërbesh 30 aleatëve dhe një miliard njerëzve. Të quhesh SACEUR do të thotë të drejtosh miliona gra dhe burra me uniformë në të gjithë Aleancën tonë dhe dhjetëra mijëra trupa nën komandën tuaj të drejtpërdrejtë. Të quhesh SACEUR do të thotë të mbrosh një zonë që shtrihet nga maja veriore e Norvegjisë në brigjet jugore të Mesdheut, dhe nga bregu i Atlantikut në kufirin lindor të Turqisë-s. Dhe të quhesh SACEUR është të mbrosh vlerat tona demokratike dhe mënyrën tonë të jetesës. Kjo është një nga punët më të rëndësishme ushtarake në botë, në një nga momentet më të rëndësishme për sigurinë tonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg në ceremoninë e ndryshimit të komandës së Komandës Aleate të Operacioneve. “Përkushtimi juaj vetëmohues ndaj Aleancës sonë na ka ndihmuar të kalojmë nëpër momente të vështira. Sigurimi që kriza shëndetësore COVID nuk u shndërrua në krizë sigurie, tranzicioni i Misionit tonë të Mbështetjes Vendimtare në Afganistan dhe duke iu përgjigjur me shpejtësi dhe forcë pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. Gjithçka duke udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin



e një plani të mbrojtjes krejtësisht të ri të familjes të NATO-s dhe duke ofruar bujarisht kohën dhe ekspertizën tuaj për ambasadorët, ministrat dhe udhëheqës të Aleatëve”, - tha Stoltenberg. Ai solli momentet sfiduese për Aleancën nën drejtimin e gjeneralit Tod Wolters. “Ju jeni vërtet një komandant i shekullit të 21-të, i cili ka vendosur një strategji gjithëpërfshirëse dhe të integruar për parandalimin e luftës. Kjo e bën Aleancën tonë më të fortë dhe më të shkathët, tani dhe për të ardhmen. Sepse nëse duam paqe, duhet të përgatitemi për luftë. Strategjia e re e parandalimit dhe e mbrojtjes së NATO-s na lejon të përforcojmë krahun lindor të Aleancës sonë brenda disa orësh pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Kjo hapi rrugën për vendimet transformuese që morëm në Samitin tonë të Madridit javën e kaluar, për ta mbajtur NATO-n të fortë dhe të shkathët dhe për të mbrojtur çdo centimetër të territorit aleat, nga çdo kërcënim, në çdo kohë, në të gjitha fushat. Falë jush, Tod, çdo komandant dhe ushtar i NATO-s e di saktësisht se çfarë duhet të bëjë dhe ka një vizion të qartë se si ato kontribuojnë në lirinë dhe sigurinë tonë. Ky është lidhshmëri”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Kur gjenerali Eisenhower përfundoi kohën e tij si SACEUR-i ynë i parë, ai e përshkroi detyrën e tij si një “detyrim fisnik”. Ai që kërkon vigjilencë të vazhdueshme, punë të palodhur, bashkëpunim dhe sakrificë. Tod, ju e keni përmbushur këtë detyrë fisnike me nder dhe dallim. Ju ishit, thjesht, lideri i duhur, në postin e duhur, në kohën e duhur. Si djali i një piloti të aftë të Forcave Ajrore, vetë një gjeneral komandues,

babai juaj pa dyshim do të kishte qenë jashtëzakonisht krenar për gjithçka që keni arritur gjatë karrierës suaj shumë të shquar ushtarake 40-vjeçare”, - tha Stoltenberg. “Nga ditët tuaja duke luajtur futboll në akademinë e Forcave Ajrore, dhe duke pasur 5000 orë fluturimi në avionë luftarakë, në komandën tuaj këtu në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë, vetë disiplina juaj dhe shpirti i ekipit ju kanë shërbyer qartë juve, dhe të gjithë neve, mirë. Jo më pak, sepse nuk keni frikë të konkurroni. Siç bëjnë të gjithë gjeneralët e mirë të Forcave Ajrore, së shpejti do të ktheheni në San Antonio, Teksas. Baza operative për familjen Wolters për shumë vite. Aty ku gruaja juaj, Charlene, tashmë ka filluar të ngrejë shtëpinë tuaj të re. Ju do të keni mundësinë të kaloni më shumë kohë me fëmijët dhe nipërit tuaj, që nuk do të jetë larg. Dhe për t'u kënaqur me pasionet tuaja sportive, Golf dhe Dallas Cowboys!”

Tod, nga unë dhe nga e gjithë Aleanca, faleminderit për udhëheqjen tuaj, përkushtimin tuaj, dhe këshillën tuaj të qëndrueshme. Ju largoheni më të fortë nga NATO dhe nga një miliard njerëzit tanë më të sigurt. Shumë faleminderit! Dhe tani është koha për t'ia dorëzuar stafetën Ushtrisë nga Forcat Ajrore”, - u shpreh Sekretari i Përgjithshëm.

Së bashku, përballë sfidave dhe mundësive të reja

“Gjeneral Cavoli, Chris. Është nderi im t'ju mirëpres, gruan tuaj Christina, dhe anëtarët e familjes suaj, këtu sot. E di që do të vazhdoni t'i shërbeni NATO-s

me të njëjtin lidhshmëri dhe përkushtim që keni treguar gjithmonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm në ceremoninë e marrjes së detyrës nga komandanti i ri gjeneral Cavoli. “Lindur në Gjermani gjatë Luftës së Ftohtë, i rritur në Itali dhe një folës i frëngjishtes, italishtes dhe rusishtes, gjeneral Cavoli ka një lidhje të përjetshme me Europën”, - tha Stoltenberg. Ai tha se karriera e tij ushtarake 35-vjeçare ka qenë e shtrirë në të gjithë globin, nga Bosnja, në Irak dhe Afganistan. Nga komandimi i njësive të këmbësorisë, për rolet strategjike në Uashington...

“Së fundmi, si Komandë e Përgjithshme e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, ju keni mbikëqyrur përf forcimin më të madh të pranisë së SHBA-së në Europë në dekada, me mbi 100 000 trupa. Ju keni komanduar stërvitje të mëdha shumëkombëshe. Kjo tregon gatishmërinë tonë dhe aftësinë tonë për të vepruar pa probleme së bashku. Ju bashkoheni me ne në një pikë kthese për sigurinë transatlantike, e shënuar nga konkurrenca strategjike në rritje dhe kthimi i luftës brutale në Europë. Së bashku me ekipin e jashtëzakonshëm në SHAPE, e di që do të vazhdoni të përballeni me sfidat dhe mundësitë me të cilat përballemi çdo ditë. Jo më pak ndërsa përgatitemi për të mirëpritur Finlandën dhe Suedinë në Aleancën tonë, dy aleatë të rinj të NATO-s me forca dhe aftësi të rëndësishme ushtarake”. Në emër të të gjithë aleatëve të NATO-s, shefi i NATO-s e uroi gjeneralin Cavolin për rolin e ri si Komandant Suprem i Aleatëve në Europë dhe në familjen e NATO-s.

Gjeneral Christopher Cavoli, Komandanti i 20-të Suprem i Aleatëve në Europë

Gjenerali i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Christopher Cavoli që mori komandën nga gjenerali i Forcave Ajrore të SHBA-së Tod D. Wolters u bë Komandanti i 20-të Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR).

Gjatë mandatit të tij gjenerali Wolters në SHAPE, ndikoi në disa momente kyçe në historinë e NATO-s, siç janë ruajtja e efektivitetit operacional gjatë Pandemisë COVID-19, pjesëmarrjen e ACO-së në Steadfast “Defender 2021”, stërvitjen më të madhe të NATO-s në më shumë se një dekadë, tërheqjen e trupave të NATO-s nga Afganistani dhe mbështetjen e evakuimit të afganëve anëtarë të NATO-s, misioni i vazhdueshëm i NATO-s në Irak, struktura e DDA-së për të kundërshtuar më mirë kërcënimet e mundshme ndaj Aleancës dhe për të siguruar paqen, sigurinë dhe prosperitetin për kombet aleate dhe përgjigjen e aleatëve ndaj pushtimit të vazhdueshëm rus të Ukrainës.

Gjatë fjalimit të tij për ndryshimin e komandës, gjenerali Wolters nga ana e tij, foli për kohën si SACEUR, duke ndarë vlerësimin për ekipin e tij që kishte ecur nëpër disa kërcënime më dinamike të sigurisë të Aleancës të parat në histori. “Për tre vitet e fundit, ju keni derdhur sinqerisht gjakun, djersën dhe lotët tuaj për të krijuar paqen. Siç tha Sekretari i Përgjithshëm, ne kemi pasur disa sfida të vështira gjatë rrugës. Asnjë nuk ishte shumë i madh dhe asnjë nuk na detyroi të ishim në një pozicion që të dorëzoheshim ndonjëherë. Është për shkak të përpjekjes vendimtare për të gjeneruar paqen që jemi në situatën që jemi sot dhe po punojmë shumë për të përmirësuar kushtet”, - tha Wolters.

Ndërkohë gjeneral Cavoli vjen në SHAPE nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën në Wiesbaden, ku shërbeu si komandant i Ushtrisë së konsoliduar të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, detyrë që e mbajti nga tetori 2020 deri në qershor 2022.

Gjatë ceremonisë, së 4 korrikut, gjeneral Cavoli shprehu mirënjohjen e tij për mundësinë për të drejtuar shtabin më të vjetër ushtarak të NATO-s. “Faleminderit të gjithëve që erdhët këtu sot. Prania juaj na nderon, por më shumë prania juaj ilustron unitetin e kësaj aleance, aleancën më të madhe në historinë e njerëzimit. Është një përfaqësim i lidhjes që na mban të bashkuar” - tha ai.

Pas ceremonisë, Kryetari i Komitetit Ushtarak (CMC), Admirali Rob Bauer shprehu rolin e rëndësishëm të SACEUR si lideri më i lartë ushtarak i NATO-s. “Gjenerali Wolters ka përcjellë SHAPE dhe US EUCOM përmes trazirave të paprecedentë. Me efikasitetin dhe energjinë e tij të pakufishme, ai punoi si me një pamje të gjerë ashtu edhe me detaje mikroskopike. Me punën e tij të pandërprerë në strategjinë tonë ‘të pengojmë dhe mbrojmë’ dhe më pas planet, ai e ka lënë NATO-n më të fortë se sa e ka gjetur. Ai do të mbahet mend si një udhëheqës ushtarak i kohës së luftës me një përzierje të fuqishme intelekti, gjykim të jashtëzakonshëm strategjik, këshilla ushtarake të patëmetë dhe të matur. Si dhe një lider i dhembshurisë, sharmit dhe venave prej çeliku. Të gjithë kemi qenë më të sigurt me të në krye”, - tha Admirali Bauer.

Gjenerali Wolters do të tërhiqet zyrtarisht nga Forcat Ajrore të SHBA-së këtë vit, me mbi dyzet vjet shërbim ushtarak.

ALEANCA QËNDRON NË SOLIDARITET TË PLOTË ME UKRAINËN NATO hap Ekspozitën “Shtëpia e Krimeve të Luftës Ruse”

Ndihmës Sekretarja e Përgjithshme e NATO-s për Diplomacinë Publike, ambasadorja Baiba Braže, më 6 korrik 2022, hapi ekspozitën “Russian Crimes War House” në selinë e NATO-s në Brusel.

Ambasadorja Braže përsëriti angazhimin e NATO-s në deklaratën e Samitit të Madridit për të punuar me palët përkatëse të interesit për t'i mbajtur përgjegjës të gjithë ata që janë përgjegjës për krimet e luftës. Duke folur në gjuhën ukrainase, ambasadorja Braže tha se: “Ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me Ukrainën dhe jemi të vendosur të bëjmë gjithçka që mundemi për t'ju mbështetur. Guximi juaj është një frymëzim”.

Ekspozita “Shtëpia e Krimeve të Luftës Ruse” përbëhet nga foto dhe një video që përshkruan mizoritë ruse në Ukrainë. Kjo do të ekspozohet në selinë e NATO-s nga 6 deri më 15 korrik. Ekspozita u shfaq më parë në Davos gjatë Forumit Ekonomik Botëror, në maj 2022, që organizohet nga Fondacioni “Victor Pinchuk”.

Ceremonia e hapjes së ekspozitës në NATO u organizua nga ambasadorja Nataliia Galibarenko, shefja e Misionit të Ukrainës në NATO. Kryetari i Bashkisë së Melitopolit, Ivan Fedorov, i cili u rrëmbye vetë në mars për disa ditë nga forcat ruse, foli personalisht për shkatërrimin e jetëve, mjeteve të jetesës dhe qyteteve të Ukrainës nga pushtimi rus. Shefi i Zyrës së Presidentit të Ukrainës, Andrii Yermak, dhe Ambasadori

i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Ukrainës, Anton Korynevych, iu drejtuan gjithashtu audiencës në distancë.

Kjo javë shënon 25-vjetorin e Kartës për një Partneritet të Veçantë midis NATO-s dhe Ukrainës, e cila krijoi Komisionin NATO-Ukrainë duke ofruar kuadrin për bashkëpunimin. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, aleatët e NATO-s kanë pajisur dhe trajnuar dhjetëra-mijëra ushtarë ukrainas. Pas pushtimit të Rusisë në fillim të këtij viti, aleatët kanë mbështetur me miliarda dollarë, armë dhe ndihma të tjera për Ukrainën, me qëllim që ajo të ruajë të drejtën e saj për vetëmbrojtje dhe të mbizotërojë kundër agresionit rus.

FINLANDA DHE SUECIA PËRFUNDOJNË BISEDIMET E ANËTARËSIMIT NË NATO

Aleatët e NATO-s nënshkruajnë Protokollat e Anëtarësimit për Finlandën dhe Suedinë

Ambasadorët e NATO-s nënshkruan Protokollat e Aderimit për Finlandën dhe Suedinë në selinë e NATO-s, më 5 korrik 2022, në prani të ministrit të Jashtëm Finlandez Pekka Haavisto dhe ministres së Jashtme suedeze Ann Linde. “Ky është me të vërtetë një moment historik, për Finlandën, për Suedinë, për NATO-n dhe për sigurinë tonë të përbashkët. “Pak më shumë se një muaj më parë, Finlanda dhe Suedia dorëzuan letrat zyrtare të aplikimit. Kjo u pasua nga javë të tëra diskutimesh intensive. Kishte shqetësime sigurie që duheshin adresuar dhe ne bëmë atë që bëjmë gjithmonë në NATO. Ne gjetëm gjuhën e përbashkët”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në fjalimin që mbajti në fillimin e ceremonisë së nënshkrimit të Protokolleve të Anëtarësimit me Finlandën dhe Suedinë.

Javën e kaluar në Samitin e Madridit, udhëheqësit e vendeve aleate ranë dakord të ftojnë Finlandën dhe Suedinë për t'u bashkuar me NATO-n pas marrëveshjes së një memorandumit trepalësh midis Turqisë, Finlandës dhe

Suedisë. “Sot ne do të nënshkruajmë zyrtarisht protokollat e anëtarësimit. Kjo shënon fillimin e procesit të ratifikimit. Dera e NATO-s mbetet e hapur për demokracitë europiane që janë të gatshme të kontribuojnë për sigurinë tonë të përbashkët. Kjo është një ditë e mirë për Finlandën dhe Suedinë dhe një ditë e mirë për NATO-n. Me 32 kombe rreth tryezës, ne do të jemi edhe më

të fortë dhe njerëzit tanë do të jenë edhe më të sigurt, ndërsa përballemi me krizën më të madhe të sigurisë në dekada”, - tha ai.

Finlanda dhe Suedia përfunduan bisedimet e pranimit në selinë e NATO-s në Bruksel, më 4 korrik 2022. Bisedimet u zhvilluan midis zyrtarëve të NATO-s dhe përfaqësuesve nga Finlanda dhe Suedia. Delegacioni finlandez u kryesua nga ministri i Jashtëm Pekka Haavisto dhe ministri i Mbrojtjes Antti Kaikkonen, delegacioni suedez u kryesua nga ministrja e jashtme Ann Linde. Takimet për secilin vend u kryesuan nga Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, Bettina Cadenbach.

Nënshkrimi i Protokolleve të Anëtarësimit, më 5 korrik 2022, shënon fillimin e procesit të ratifikimit.



ZËVENDËS SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S NËNVIZON RËNDËSINË STRATEGJIKE TË RAJONIT TË DETIT TË ZI

Mircea Geoana: Deti i Zi, çelësi për parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană theksoi rëndësinë strategjike të rajonit të Detit të Zi për NATO-n në fjalën e tij në Samitin e Komisionit të SHBA për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE) të Detit të Zi në Konstancë, Rumanë, të mbajtur pas Samitit të Madridit. Z. Geoană vuri në dukje se Deti i Zi është çelësi për parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s dhe pasqyron konkurrencën më të gjerë midis Rusisë revizioniste dhe brutale dhe agresive dhe botës sonë demokratike. Ai falënderoi më tej aleatët e NATO-s në kufi me Detin e Zi për punën e tyre për të forcuar Aleancën dhe për të mbështetur Ukrainën pasi ajo i reziston pushtimit të Rusisë, duke mirëpritur përpjekjet për të nxjerrë grurin nga Ukraina dhe rolin e Turqisë në kufizimin e aksesit në anijet luftarake ruse.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti më tej shumë vendime historike të marra në Samitin e Madridit të NATO-s në fillim të javës, duke përfshirë një ndryshim thelbësor në parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës, si dhe më shumë mbështetje për Ukrainën.

Mbajtur nga KSBE, i njohur gjithashtu si Komisioni i Helsinkit, Samiti i Detit të Zi mblodhi së bashku zyrtarë të lartë, përfshirë ministrin rumun të Punëve të Jashtme Bogdan Aurescu dhe ministrin ukrainas të Mbrojtjes Oleksii Reznikov.

“Samitet e NATO-s janë historike, por ky i fundit ishte një samit vërtet transformues i NATO-s. Rusia sot është kërcënimi numër një për Aleancën. Koncepti ynë strategjik i miratuar nga udhëheqësit tanë e pranon këtë. Ne e konsiderojmë gjithashtu ngritjen e Kinës si një sfidë të rëndësishme për interesat, vlerat dhe sigurinë tonë. Ne gjithashtu e konsiderojmë Detin e Zi si një nga zonat kritike me rëndësi strategjike për NATO-n. Në mikro Deti i Zi po reflekton konkurrencën më të gjerë midis Rusisë revizioniste, brutale dhe



agresive dhe botës sonë demokratike. Kjo është arsyeja pse ky rajon pasqyrohet në Konceptin Strategjik si një rajon me rëndësi strategjike maksimale për NATO-n”, - tha në hyrje të fjalës së tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană në Samitin e Detit të Zi.

Ofensiva e suksesshme e ushtrisë ukrainase në ishullin e Gjarprit, që çoi në çlirimin e kësaj pjese të rëndësishme të vendndodhjeve strategjike në Detin e Zi, është një hap i parë në rivendosjen e lirisë së lëvizjes, anijeve dhe lundrimit në Detin e Zi. “Kjo është shumë e rëndësishme për NATO-n në ofrimin e sigurisë për aleatët në breg, dhe fillimin e zbatimit të vërtetë të vendimeve që morëm në Madrid”, - tha Mircea Geoană.

Ai ritheksoi edhe një herë ‘përcaktimin’ se Deti i Zi është një vazhdimësi natyrore me Mesdheun. “Nuk është Deti i Zi dhe Deti Azov dhe detet e tjera. Është një det. Të gjitha detet janë të lidhura. Zinxhirët e furnizimit, infrastrukturat, lëvizshmëria ushtarake, karburantet, gjëra që janë shumë të rëndësishme për ne”, tha numri dy i NATO-s”, - tha ai.

Në mbyllje ai tha se situata që po kalojmë duket të jetë një moment

zgjimi për të gjithë aleatët. “Ky duhet të jetë moment i një thirrjeje zgjimi për të gjithë ne, për të forcuar frenimin dhe mbrojtjen, për të investuar më shumë në mbrojtje si dhe për të shfrytëzuar këtë moment për të rienergjuar shoqëritë tona demokratike”. Ai nënvizoi se: “trekëndëshi i shenjtë” midis qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile është forca jonë dhe vënia në punë e këtij trekëndëshi të shenjtë është gjëja më e rëndësishme që

kemi”, - tha Geoana.

“Do të vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje të veçantë këtij rajoni, Detit të Zi, krahas ndihmës për Ukrainën dhe Gjeorgjinë”. Aleatët në brigjet e NATO-s në Detin e Zi, si Bullgaria dhe Turqia, luajnë një rol kritik në këtë rajon, sidomos në situatën e luftës në Ukrainë në përpjekjet e Rumanisë, Turqisë etj., për të lehtësuar eksportet e drithit nga portet e Ukrainës.

POST SAMITIT TË NATO-S NË MADRID Kryetari i Komitetit Ushtarak përgëzon Spanjën për kontributet e fuqishme në Aleancë

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, qëndroi në Spanjë, pas Samitit të NATO-s, për t'u takuar me Madhërinë e Tij Mbretin Felipe VI, ministrin spanjoll të Mbrojtjes, Margarita Robles Fernández, shefin e Mbrojtjes, admiral López Calderón dhe zyrtarë të tjerë spanjollë. Kryetari i Komitetit Ushtarak vizitoi gjithashtu Korpusin e Shpejtë të Dislokueshëm të NATO-s në Spanjë (NRDC-ESP), ku u takua me komandantin e saj, gjenerallejtënant Fernando Garcia-Vaquero dhe mbajti një leksion.

Në nisje të vizitës së tij zyrtare, admiral Rob Bauer u takua me shefin e mbrojtjes spanjolle, admiralin López Calderón, për të diskutuar mbi vendimet e marra nga krerët e shteteve dhe qeverive aleate në Samitin e Madridit. “Rezultatet e shpallura në Samit do të kontribuojnë në forcimin e parandalimit dhe qëndrimit mbrojtës të NATO-s. Tani, Autoritetet Ushtarake të NATO-s do të shohin që t'i çojnë këto përpapa

me efikasitet, me shkathtësi dhe në kohën e duhur”, - komentoi ai.

Gjatë takimit me Madhërinë e Tij, Mbretin Felipe VI, admiral Rob Bauer i uroi Mbretit për 8-vjetorin e kurorëzimit të tij dhe 40-vjetorin e Spanjës si anëtare e NATO-s. “Për 40 vjet Spanja ka qenë një anëtare e përkushtuar e Aleancës sonë, duke dhënë kontribute të rëndësishme për sigurinë tonë të përbashkët, duke mbështetur kolegët aleatë dhe partnerë, si dhe duke rritur gatishmërinë tonë operacionale duke pritur trupat aleate”, - theksoi Kryetari.

Duke diskutuar mbështetjen e Spanjës për NATO-n me ministrin spanjoll të Mbrojtjes, Margarita Robles Fernández, admiral Bauer përgëzoi Spanjën për angazhimin e saj të qëndrueshëm. “Trupat, avionët dhe kapacitetet spanjolle ofrojnë mbështetje të rregullt për misionet dhe operacionet e NATO-s. Spanja gjithashtu luan një rol vendimtar në ofrimin e trajnimeve për trupat aleate dhe partnere, përmes ushtrimeve si FLOTEX-22, stërvitja më e madhe vjetore e organizuar nga Marina spanjolle”, - shtoi admiral Bauer.

Në ditën e dytë, admiral Bauer vizitoi Korpusin e Shpejtë të Dislokueshëm të NATO-s në Spanjë (HQ NRDC-ESP), të vendosur në kazermën “Santo Domingo”, ku u takua me disa nga katërqind trupat aleate të vendosura atje, admiral Bauer përgëzoi gjenerallejtënant Fernando Garcia-Vaquero, komandantin e tyre për përkushtimin dhe profesionalizmin. “Trupat spanjolle të dislokueshme të shpejtë mishërojnë më të mirën e Aleancës sonë. Ai nuk është vetëm një shembull i mrekullueshëm i mbështetjes së Spanjës për parandalimin dhe qëndrimin mbrojtës të NATO-s, por edhe një shembull i shkëlqyer i punës ekipore, solidaritetit dhe gatishmërisë, qëndrimi i gatshëm dhe i aftë për të vepruar në të gjithë spektrin e misioneve të NATO-s”, - nënvizoi Admrali.

Ai e përfundoi vizitën e tij duke mbajtur një leksion për personelin ushtarak dhe civil në Shtabin Ushtarak Tokësor të Gatishmërisë së Lartë Spanjolle dhe trajtoi disa nga rezultatet e Samitit të NATO-s. Ai foli për aftësinë e NATO-s për t'u bashkuar dhe përshtatur, si dhe për perspektivën 360° të NATO-s për sigurinë. Gjatë vizitës në vend, admiralit Bauer iu dha Kryqi i Madh në Urdhrin e Meritës Detare nga admiral López Calderón.

Nga kolana e librit "Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë"

Vajzat e teatrit...

(Për studentet ushtarake, aktoret e talentuara që bënë emër në skenat e vendit dhe fituan çmimet e para)

Në mesin e viteve 70-të, menjëherë pas goditjes së grupit armiqësor në Ushtrinë Popullore Shqiptare, ndjehej një frymë e re. Një lloj kujdesi i tepruar në edukimin dhe argëtimin e efektivave. Për hir të së vërtetës, që në krye të herës, le të theksojmë që kjo frymë u shoqërua edhe me një lloj liberalizmi, sidomos në formalizmin, që pothuajse kishte asfiksuar çdo lloj lirie thelbësore. Por edhe në avancimin e koncepteve për mënyrat e edukimit dhe argëtimin të efektivave të ushtrisë. Kjo çoi në fokusimin më të mirë në kohën e lirë, sidomos në cilësinë e saj për argëtimin sa më të shëndoshë të efektivave, duke neglizhuar edhe disa forma të vjetruara të argëtimin dhe edukimit, qoftë në kohën e programuar e qoftë jashtë saj në marrëdhëniet ndërvepruese në efektivat e Ushtrisë. Pra e thënë më shqip më pak leksione e propagandë bajate dhe më shumë veprim konkret drejtpërdrejt te efektivat.

Në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë iu kushtua shkollave ushtarake, si vatra të edukimit ushtarak, kulturor e atdhetar të kuadrove ushtarakë. Kjo reflektoi më së shumti në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve. Krahas përfshirjes në reformën arsimore, ku qe bërë njehsimi me ligj i këtij institucioni arsimor me të gjitha institucionet e tjera të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, gjë që u reflektua në kurrikulat dhe programet përkatëse mësimore. Por, siç e theksova dhe më lart, iu kushtua një vëmendje e veçantë kohës së lirë dhe veprimtarive argëtuese kulturore e artistike. Atë kohë në Ushtrinë Shqiptare funksiononin dy institucione të fuqishme artistike, siç ishin Ansambli i Këngëve e Valleve të Ushtrisë dhe Estrada e Ushtrisë, të cilat i binin kryq e tërthor gjithë territorit të Republikës, deri në skajet më të largëta ku ishin të dislokuara repartet dhe nën-repartet e ushtrisë, me misionin finisnik të argëtimin të efektivave. Por ama nuk kishte një trupë teatrale të ushtrisë. Në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, ishte hedhur një ide e tillë për krijimin e një grupi të tillë amator, madje kishte dhe një grup nismëtar lëvruar e mbrojtës të kësaj ideje. Menjëherë nga Ministria e Mbrojtjes jepet drita jeshile. Pas urdhrave përkatës për krijimin e këtij grupi si dhe fondet përkatëse për përballimin e shpenzimeve të kostos së realizimit të një shfaqjeje teatrale, si regjia, skenografia, kostumografia, turnetë, etj., nisi realizimi. Kështu lindi ajo lulëkuqe, që mbeti e tillë, për aq sa jetoj, në atë institucion arsimor ushtarak, por edhe më gjerë. Nga grupi teatral i kësaj shkolle, në periudhën 1976-1979, u vunë në skenë tri drama të autorëve vendës të kohës. Në sezonin e parë 1976-1977, u vu në skenë drama "Gjëmimi i atij Dimri", e autorit Teodor Laço. Në sezonin e dytë 1977-1978, u vu në skenë drama "Plumbat e Shkronjave". Dhe në sezonin 1978-1979, u vu në skenë drama "Udha për në Male", e autorit Alfred Kanini. Dy shfaqjet e para u luajtën edhe në sallën e Teatrit Kombëtar në kuadër të konkurrimit të teatrove amatore ku trupa është vlerësuar me çmim të parë. Pikërisht për këtë lulëkuqe dua të shkruaj sot, por për pjesën më të bukur të saj, për "Vajzat e Teatrit".

Pasion, përkushtim, punë

Fillimi i dhjetorit 1976. Jam në mjediset e Shkollës së Lartë të Bashkuar të oficerëve. Jam ulur në një nga stolat në lulishten para Fakultetit Gjitharmësh. Kam në dorë Urdhrin e Komandës së Shkollës për krijimin dhe përbërjen e grupit të teatrit, ku sqarohet e gjithë infrastruktura dhe lehtësitë e nevojshme për realizimin e vënies në skenë të dramës së përzgjedhur. Pres të takohem me nismëtarët e krijimit të këtij grupi



teatral, Feksor Shkurti e Mark Lala (ndjesë pastë). Dua të bisedoj me ta rreth idesë time për të shkruar për vajzat e teatrit. Është një pasdite e ftohtë tipike dhjetori dhe duke ndenjur në atë stol të drunjë, këtë e ndjen disi më shumë. Të duket sikur dhjetori të ka ngulur dhëmbët mirë e të rrëqeth deri në asht. Por për fat, këta djem entuziastë, nuk vonuan dhe pritja ime nuk ishte asgjë. Ata erdhën me një buzë gaz të nderë tej e tej në fytyrat e tyre të skuqura sa prej të ftohtë, e sa prej gëzimit të brendshëm që u dallohej në sytë plot shkëlqim. Dhe kishin të drejtë. Një ëndërr e kahershme e tyre po bëhej realitet, një ëndërr që ata e kishin ushqyer për vite njëri në gjimnazet e Tiranës e tjetri në shkollën "Skënderbej".

Si u përshëndetëm përzemërsisht, si të ishim miq të vjetër, u ulëm një çast në stolin e drunjë.

- E arritët këtë ditë më në fund, - ngacmova menjëherë, ende pa u ulur mirë.

- Po, po për fat të mirë, nuk e merr dot me mend sa na ka gëzuar kjo, - gjegji Marku.

- Përveç kësaj, - vijon Feksori, - të realizosh një ëndërr është gëzim i dyfishtë. Përveç se ne e kemi ngritur e mbrojtur si ide, tashmë do të jemi edhe protagonistë në realizimin e kësaj ëndrre. Ndaj i jemi vënë punës me mish e me shpirt për të justifikuar besimin që na është dhënë.

- Po, keni nisur nga puna dhe si po ju ecën, - pyeta sërish, pa e adresuar pyetjen tek ndonjëri prej tyre.

- Po, po, kemi ecur goxha, - gjegji sërish Feksi, (kështu e thërrisnin shoqet dhe shokët e grupi).

- Tani kemi mbaruar me punën në tavolinë e kemi nisur provat e para në skena me mizanskenat.

- Tani, regjisori ynë Pal Delia po punon fort për të na familjarizuar me skenën, me vendet tona me hyrje daljet, me momentet e këmbimit të batutave, etj. Dhe ai është i tmerrshëm, skrupuloz e tejet detajist, - ndërhyu Marku. - Na e "mori shpirtin", - shton ai duke buzëqeshur me atë buzëqeshjen e tij karakteristike që i krijonte dy gropëza të bukura nën mollëzat e faqeve.

- Sot të them të drejtën, unë dua të shkruaj për vajzat e këtij grupi. Ato janë objekt e subjekt i shkrimit tim, - u thashë.

- Bukur! Në gjirin tonë kemi një grup vajzash të mrekullueshme, - u përgjigjën të dy thuajse në një gojë.

Menjëherë më zgjatën një fletë volant të shfaqjes, që ishte ende një bocet, i përgatitur me mjeshhtëri nga piktori student ushtarak Fejzo Lala, që njëherësh ishte edhe piktori i shfaqjes. Lexoj në volant që kam në dorë personazhet dhe aktorët përkatës:

Ruzja - Vali Dhrima
Hurmaja - Elvira Sulku
Arziko - Mimoza Abdihoxha
Gruaja e mullisit - Dhoksi Valera

...U nisëm menjëherë drejt katit të dytë në godinën përballë ku qe vënë në dispozicion të grupit një sallë fare e vogël që bënte edhe punën e një zyre, ku grupi mbledhej e diskutonin me regjisorin rreth mbarëvajtjes së shfaqjes. Si u prezantova me të gjithë grupin, një pjesë të madhe të të cilëve i kisha shokë të vjetër që nga shkolla "Skënderbej" e madje ishim edhe në të njëjtin fakultet. Më pritën me kënaqësi e më ftuan të ulesha diku nga mesi i tavolinës së gjatë që e përshkonte të gjithë atë sallë të vogël. Jo pa qëllim, vajzave u thërrisja me emrin e personazhit të tyre dhe kjo shkaktoi të qeshura. Ja takoj të parën Ruzen, më pas vjen gruaja e mullisit (çudi pse autori e ka lënë pa emër këtë personazh). Më tej Akoma Hurmaja dhe në fund fare edhe Arziko.

Ato u ndjenë disi të sikletosura kur u thashë se kam ardhur të shkruaj pikërisht për to. Disi të ndrojtura e pa atë gjallërinë e së përditshmes.

- Po çdo të themi ne, akoma nuk kemi dhënë shfaqje, regjisori i di ato pune, -etj. Por Ruzja e ç'tensionoi situatën.

-Moj goca, po ne do dalim në skenë e do luajmë gjithë ato role, jo më nuk themkemi dot dy fjalë për një shkrim gazete!

Kjo e dha efektin e saj, sepse vajzat menjëherë nisin të prononcohen ndaj pyetjeve të mia ndoshta stereotipe, por që ashtu duheshin. Si: "Kur nisi kjo ëndërr e jotja?", "Kur ke dalë për herë

të parë në skenë?", "A ke hasur në paragjykimet?", etj. Unë do t'i ndiqja për disa ditë gjatë provave dhe më pas do të përfundoja reportazhin tim.

Menjëherë grupi nisat drejt kinemasë së shkollës për provat e radhës. Ndërsa grupi kalonte mes për mes oborrit të shkollës të gjithë studentët i shihnin me admirim:

- Ja këta janë ata të teatrit?

- Janë artistë, s'ke ç'thua!

- E po do talent kjo punë, nuk e bën dot kushdo...!

- I kam zili po kur do e shohim shfaqjen xhanëm?

I dëgjoja këto grimca dialogësh në ecje dhe të them të drejtën, u emocionova. Këta djem e vajza studentë ushtarakë, kanë marrë përsipër një detyrë jo të lehtë. T'u flasin zemrave të shoqeve e shokëve të tyre nga skena, me gjuhën e artit. Po njëherësh, u ndjeva edhe krenar që atë moment isha mes tyre.

Menjëherë me të mbërritur në sallën e kinemasë, me një disiplinë të jashtëzakonshme, secili zë vendin e tij pas kuintave, në pritje të urdhrin të regjisorit për nisjen e provës, me aktin e parë. Sigurisht, në këto prova të para, nuk bëhej fjalë për tempo-ritmin e shfaqjes, sepse çdo hap, çdo fjalë, çdo batutë e lëvizje, duheshin saktësuar një e nga një sipas idesë se regjisorit. Më impresionoi pa masë ajo disiplinë e ajo gatishmëri për të dalë sa më mirë. Ky ishte përkushtim dhe nuk mund të gjeje fjalë tjetër në fjalor. Ata e përpinin çdo fjalë të regjisor Palit, nuk përtonin ta bënin edhe dhjetë herë një skenë, një batutë të vetme. Prova të lodhshme e sflitëse, gjer në orët e mbrëmjes. Pas kësaj, një çaj i ngrohtë e pak djathë kaçkavall. E pas kësaj drejt e në sallat e studimit, për t'u përgatitur për kologiumin a seminarin e radhës. Nuk mund të lë pa përmendur faktin që të gjithë ato vajza e djem, ishin studentë të shkëlqyer me rezultate shembullore. Vijoi kjo punë e palodhur për javë e muaj dhe ja, vjen dita e premierës. E unë ndiqja çdo hap të grupit, çdo përparim, deri në arritjen e asaj optimalet. Po sidomos, më bënte për vete përkushtimi i vajzave të grupit.

Asnjëra prej tyre dhe asnjëherë, nuk tha "u lodha". Asnjëra prej tyre, nuk u mërzi kur i bërtiti regjisori, kur gaboi tekstin apo vonoi batutën. Ato punuan me një lloj dinjiteti të papërshkrueshëm për të arritur më të mirën. Ato, si të thuash, kishin bërë një betim: "do të jemi në pararojë të grupit".

...Dhe ja, mbërritëm këtu në ditën e premierës. Salla e kinemasë e kishte dyfishuar kapacitetin e saj. Herë-herë, dëgjohej ndonjë thirrje pasionante "Bravo", që ndoshta qe një mesash për dikë këtu pas kuintave, aty ku jam ngujuar dhe unë së bashku me vajzat e teatrit.

Aty pas kuintave, përpiqem të marr ndonjë mbresë, ndonjë emocion prej vajzave protagoniste, por ishte tejet e vështirë. Të gjitha "flasin me vete". Përsërisin batutat, kontrollojnë veshjen, po edhe grimin e tyre në një pasqyrë që ishte varur enkas në murin pas kuintave. Ata janë në lëvizje pa pushim dhe, është e pamundur ta prishësh ritualin e tyre. Po gjithsesi mua nuk më rrihet. Dua të mësoj diçka se si ndjehen këto vajza të mrekullueshme tani, tek presin nga çasti në çast të nisë premiera e tyre.

- Hë Ruze, si ndjehesh? - i drejtohem Vali Dhrimës.

- Mos më pyet, po më merret fryma, do më bjerë të fikët, - më përgjigjet.

- Vali do dilni shkëlqyeshëm. Me gjithë këtë punë që keni bërë ju, jeni bërë profesionistë, ke për të parë sa mirë do shkojë, - mundohem t'i jap kurajë.

Ajo buzëqesh dhe vijon me ecejaket e saj.

Arziko (Moza), duket disi më e çliruar. Me atë zërin e saj karakteristike, disi të çjerrë, u drejtohet vajzave: - Mos çani kokë goca. Sa të dalim në skenë, gjithçka zhduket, nuk ka më emocione, çdo gjë kthehet në normalitet. Do dalim mirë, si ka thënë regjisori, aty mbaron prova dhe nis e vërteta. Keni për të parë...!

- Mirë mirë, po ishalla nuk harrojmë të dalim në skenë thuaj, - qesëndisi Hurmaja (Elvira).

Dhoksia e heshtur qesh e përpiqet

të mos shpërthejë me të madhe. Qeshën të gjitha vajzat, qeshëm edhe ne me gjithë shpirt... Një tringëllimë zile... Gati të hapet sipari...

...Sipari nis të hapet ngadalë dhe nis kështu premiera e parë e këtij grupi amator teatral. Shfaqja rrjedh bukur në ritmin e saj. Pas çdo skene dhe akti, duartrokitjet nuk kishin të sosur, shoqëruar edhe me britma ndonjëherë. Pritje e jashtëzakonshme e lojës së aktorëve të kësaj trupe. Në fund kur aktorët përshëndesin publikun e zjarrtë, me daljen e grupit të vajzave të teatrit, tufat me lule që vinin herë pas here, në skenë krijohet një pemë e tërë me lule.

Vajzat me lot në sy, me shikimet e hedhura rreth e rrotull në sallë, shtrëngojnë fort duart me njëra-tjetrën, në kordinin e krijuar sikur do ia merrnin një valleje dhe përuleshin thellë para këtij spektatori të mrekullueshëm. Tashmë ato nuk mundoheshin fare t'i fshihnin lotët. Sukses! Sukses!

Pasi mbyllet sipari, të gjithë gjenden në një përqaqim dashurie dhe malli, mirënjohje e respekti për punën e për njëri-tjetrin. Edhe regjisor Pali, i për-lotur, mes tyre mezi gjen fjalët duke i përqaquar të gjithë me radhë. “Bravo bravo, jeni djem e vajza të mrekullueshme, jeni profesionistë të vërtetë. Keni dhënë një shfaqje vërtetë dinjitoze. Jam krenar, jam krenar me ju...” E fjalët i ngatërrohen më tej... Unë aty mes tyre, i për-lotur aq sa ata, me planin tim në xhep për të bërë disa intervista për të marrë impresionet e para pas provës para publikut. Futa dorën në xhep dhe e zhubravita atë copë letër, e bëra shuk dhe e urreva atë moment. Unë i kisha marrë impresionet në një shkallë sipërore. Kisha marrë edhe kritikën e publikut. Të nesërmen, gazetatat përcillnin lajmin e suksesit, lojës së kësaj trupe e, jo vetëm në shtypin ushtarak. Nuk munguan edhe përgëzimet nga ana e autoriteteve të shkollës por edhe të Ministrisë së Mbrojtjes duke vlerësuar me nota të larta punën e bërë nga e gjithë trupa dhe infrastruktura e saj.

Ditët kalojnë dhe kjo trupë merr ftesën nga Ministria e Kulturës për të marrë pjesë në konkurrimin e grupeve teatrale amatore që do të zhvillohej pas një muaji. Trupa u lejua. Ajo dha një shfaqje tejet të suksesshme në sallën e Teatrit Kombëtar. Për këtë ajo nderohet me çmimin e parë. Sukses! Sërish sukses i këtyre djemve e vajzave.

Me të njëjtin përkushtim e disiplinë, nisi edhe përgatitja e dramës së dytë, në sezonin 1977-1978. U përzgjedh drama “Plumbat e Shkronjave”. Tashmë si regjisor ishte afruar një profesionist i vërtetë, Lutfi Zyka. Vajzat e teatrit sërish janë aty për të nisur nga e para kalvarin e vështirësive e për t'ia dalë mbanë. Tashmë në radhët e tyre është shtuar edhe Alma Subashi, Majlinda Myftari e Ameli Kurupi. Tashmë ato ndjehen më të forta e më të sigurt, madje nuk mungonin edhe romuzet në drejtim të grupit të djemve të trupës. Sërish vështirësi, sërish lodhje e net pa gjumë. Sërish rituali i provave me disiplinën e pa cënueshme dhe me ndihmën e vyer të regjisorit. E nuk vonoi të përsëritet suksesi. Premierë e jashtëzakonshme, publik akoma më i zjarrtë e natyrisht, më shumë lot gëzimi në sytë e vajzave. Përsëri kjo shfaqje merr pjesë në konkurrimin e teatrove amatore dhe përsëri nderohet me çmimin e parë. Tashmë ajo trupë ishte kthyer në një magji, jo vetëm për spektatorin ushtarak, por edhe për atë të Tiranës. Natyrisht, tashmë fama e kësaj trupe kishte tërhequr edhe vëmendjen e titanëve të skenës si Reshat Arbana, Robert Ndrenika, Margerita Xhepa, Mirush Kabashi e të tjerë, të cilët e kanë përcjellë me fjalët më të mira lojën e saj.

...Koha kalon dhe trupa gjithnjë e më shumë konsolidohet. Kështu pa zhurmë e pa bujë nisi puna për të vënë dramën e tretë në sezonin 1978-1979.

Dhe ëndrra është e gjallë sa kohë që janë gjallë ato djem e vajza të mrekullueshme.

Një ditë, tek pinim kafe me Kudret Salihajn dhe Mersin Kurtin, na lindi ideja që të rijetojmë disa emocione nga ajo koha e bukur e teatrit. Të takohemi e të kujtojmë, të qeshim e të mendojmë për kohën e miqësinë tonë. Kështu ngritëm faqen “Ekran Artistik”..., ku rrahëm mendimet me gjithë grupin për organizimin e një takimi të gjithë grupit. Dhe më në fund kjo u bë një realitet, natyrisht me një grup të vogël, aq sa për të nisur një traditë që nuk do të ndalet. Dhe ja, vjen 20 dhjetori 2018. Në një nga lokalet e Tiranës takohet grupi i teatrit. Ja tek vijnë me radhë Lefteri e Ymeri, Bardhyli e Bilbili, Kudreti e Mersini. Po ato që na lumurojnë më shumë, janë vajzat e Teatrit. Ato kanë lënë impenjimet e tyre familjare për përgatitjet e krishtlindjeve e vitit të ri dhe kanë ardhur aty për të festuar e kujtuar së bashku me ne. Alma, që është dhe me bashkëshortin, nuk ka harruar të marrë kitarën, dashurinë e saj të parë. E gjallë e me temperamentin e saj eksploziv, ajo menjëherë nis të bëjë atë që di ta bëjë bukur, të këndojë. E sakaq, tingujt e kitarës kanë pushtuar sallën e restorantit dhe shpërndajnë ëmbëlsisht copëza kujtimesh nga ajo kohë e bukur, kur krahas taktikës dhe zjarrit, ne bëmë edhe teatër. Vajzat, në bazë edhe të kërkesave tona, nisin të parat me kujtimet e tyre. Vali, si gjithnjë kujton me humorin e saj detaje nga “gabimet” në skenë dhe reagimet e regjisorit, për gotën e çajit që nuk e pinte dot apo për rripin që nuk e shtrëngonte dot pas mesit. Meli dhe Alma kanë kujtime të detajuara. Ato tregojnë secila nga një ngjarje të asaj kohe. Ato përçojnë tek ne, krahas kujtimeve edhe humor të mrekullueshëm. Kështu ajo drekë ndizet mes kujtimesh, tingujve të muzikës, ritmit të valleve, po pse jo, të mishit e të verës së mrekullueshme që kishim në tryezat tona. Vioji gjatë ajo pasdite, aq gjatë sa e kishim të vështirë të ndaheshim me njëri tjetrin, aq sa për të na kujtuar që kjo duhet kthyer në traditë.

Ja çfarë kujtoi Amelia:

Për mua, qenia në grupin e vajzave të teatrit, ka vlere të dyfishtë. Përveç emocioneve të rolit e të punës në grup, unë njoha bashkëshortin tim. Dhe kjo lidhje, në fillimet e saj ka të bëjë pikërisht me teatrin. Ju duket e çuditshme por ky është realitet. Ishte data 22 gusht e vitit 1987 dhe ndodhesha me pushimet e verës, atje në fshatin e tezes time, në bregun e Jonit. Pasi, sapo kisha mbaruar maturën në një nga gjimnazet e Tiranës, tashmë isha në fazën e thurjes së ëndrrave për të ardhmen. Ajo kryesorja, ishte për degën e studimeve në Universitet. Për çfarë do të studioja vallë? Sigurisht unë e kisha përgjigjen time: Mjekësi. Por a do të realizohej?

Por ishte pikërisht ai fund gushti që vendosi shumëçka në jetën time, thënë shkurt, në profesionin që do të merrja unë, kaq larg mjekësisë. Por edhe në fatin tim të jetë, që deri në atë kohë as që e kisha çuar nëpër mendje. Ditët e mia shtyeshin mes Sarandës dhe fshatit të gjyshërve. Sa herë unë shkoja në fshat, ishte një djalë bukursh, që kalonte dhe ai pushimet aty, më ndiqte me shikime lakmitare e studionte me imtësi sjelljet e mia si çupë kryeqyteti. Veçanërisht, kur shkoja tek halla që ishte infermiere në qendrën sanitare të fshatit. Por unë sinqerisht, as që e kisha vënë re fare dhe as më interesonte.

Por ky bukursh, na kishte korruptuar hallën time dhe së bashku, po thurnin ca plane për një takim. Pikërisht, ajo data 22 gusht është e shënuar. E shtunë në drekë, tek mbushja ujë që të isha sa më e dobishme. Si në folk ë? Kur mbush vasha ujë në krua... Ky bukursh, me mjaft elegancë afrohet dhe nis nga pyetjet gjoja rastësore, gjoja të pamenduara më parë: Kur ke mbaruar gjimnazin, për çfarë do studiosh, etj.

Si këto... Në fund, si mori një lloj serioziteti në fytyrën e tij të bërë flakë, më thotë se kishte kohë që donte të bisedonte me mua dhe se jo rastësisht vinte çdo ditë tek ambulanca, por për të më parë mua e të gjente rastin për të biseduar me mua. Madje unë, i paskësha mjekuar edhe dorën disa herë, që një zot e di si e kishte vrarë aq shpesh. Mbete pa frymë. Më trulloi. Si nuk e kisha vënë re fare, as që i kisha hedhur sytë. E mblodha veten dhe ashtu si di unë, lëshova lumin e pyetjeve të mia: Çfarë ke mbaruar, ku studion, etj. Të them të drejtën, nuk është se më zgjoi ndonjë interes. Kur më tha se ishte student ushtarak në degën e Prapavijës, disi u pezmatova por nuk e dhashë veten. Përgjithësisht, në mendjen time, ishte ngritur një mendim jo pozitiv për oficerët, pa ndonjë bazë apo motiv konkret. Ndikuar prej kësaj, ia preva shkurt, mos e zgjat fare muhabetin, fare, se unë do të vazhdoja për mjekësi. Nuk mund të bashkohej një oficer me një mjeke, më thoshte logjika ime dhe, ia shpreha në sy. Befas ky bukursh i fjalëve të ëmbla e plot edukatë kal-orësiake, u bë disi i rreptë e gjykues i ashpër. - Ou, - bëri ai, - si gjykohej njeriu kështu pa e njohur? Po unë të uroj që të dalë shkolla për oficerë e të të ulet pak hunda, se e paske shumë përpjetë...

Në atë moment qesha. Qesha sepse deri në atë kohë, nuk e dija që paska edhe vajza oficerë. Në të ndarë, ai ngulmoi në të vetën. - Gjithsesi ti mendohu, - më tha me një lloj nënqeshje.

Atë ditë, si për çudi e për koincidence, rreth orës 6 pasdite, me autobusin e linjës që vinte nga Saranda, vjen një telegram i dërguar nga familja ime. Dhe po çuditërisht, ky telegram bie ne dorën e këtij bukursh. Me telegramin në dorë e me fytyrën që i qeshte cep më cep, vjen e më gjen tek furra e bukës. Më saluton e më thotë pa e zgjatur: - të ka ardhur një telegram nga Tirana, - dhe ma la në dorë atë copë letër. E lexova dhe nisa të qesh me veten time. Menjëherë më shkoi mendja te bukursh. Nga ia paska gjetur anën sa të sajohet edhe këtë?

“Nisu urgjent për Tiranë, të ka dalë shkolla për oficerë, je me vonesë”! Kaq thoshte telegrami. - Mos e merr me shaka, - ma thotë ai plot krenari, me që kishte vënë re edhe nënqeshjen time. - Ta ka shkruar motra apo jo?

Nuk dija dhe nuk doja të besoja asgjë. Gjithsesi u nisa për Tiranë. Ishte e vërtetë. Duhet të bëhesha gati. Për herë të fundit u them shoqeve na blini bileta për në teatër, se luhej nja dramë e bukur me gjigandët e skenës shqiptare. Ashtu u bë.

Atë pasdite drejt e në sallën e Teatrit Kombëtar. Shuhen dritat nis shfaqja, por... Shihnim njëra-tjetrën në sy. Nuk po kuptonim. Ishte shfaqje tjetër. U tërbova dhe doja të ikja me vrap. Po shoqet më mbajtën. Lere tani, erdhëm, nuk ka lezet të ikim kështu. Desha s’desha u ula. Kur... Uau, në skenë ishte bukursh i fshatit, atje në bregun e Jonit. Ai po luante rolin e mullisit në atë dramë. Luante bukur dhe qe shumë profesional. Nuk e di pse më rrodhën dy pika lot tatëpjetë faqeve. Vërtetë ka një zot që prej atje lart i rregullon punët si di ai.

Që nga ai moment, deri më sot ai bukursh që quhet Fekso Shkurti, nuk m’u nda për të gjithë jetën time. Ja ky bukursh që kam këtu pranë duke e përqaquar dhe puthur.

...E gjithë salla shpërtheu në duartrokitjet frenetike, sikur sapo kishte mbaruar një shfaqje teatrale e suksesshme. Edhe personeli i lokalit u bashkua me ne. Gëzimi merr krahë.

Më tej vazhdojnë doli të...

Po Alma, çfarë na solli atë ditë në kujtimet e saj?

Për mua ajo kohë, ajo punë sfilite, ato emocione që kemi marrë, gjatë kohës kur bënim teatër, janë të pa përsëritshme në jetë. Po janë edhe

një mësim i madh qe kemi marrë përtej programeve të shkollës. Unë ruaj si thesare të miat, dy momente që më kanë lënë mbresa të mëdha. Kujtoj momentin e dramës së fundit, kur në oborrin e shkollës më takon Luto (Lutfi Zyko, regjisor) dhe më thotë se në orën pesë, tek salla, do të mbledhet grupi i teatrit. Do të nisim provat me dramën e re “Rruga për në Male”, e autorit Alfred Kanini. Zemra më rrihte aq fort, sa kujtova se do më linte atë çast. Kështu nisi puna për të vënë në skenë këtë dramë, që për hir të së vërtetës, më pëlqeu shumë si tekst dhe roli që m’u dha. Pas punës së lodhshme, gjenim pak kohë edhe për një këngë edhe për një valle. Kitaru nuk na ndahej asnjëherë. E kjo sikur na çlodhte e na jepte energji të reja për ditën e nesërme, që mund të ishte edhe më e ngarkuar. Ditë pas dite e javë pas javë, shfaqja mori formën e saj të plotë dhe ishte gati për premierën. Mbaj mend që të gjithë në pjesëtarët e grupit të teatrit, por veçanërisht ne, vajzat e teatrit, gëzonim si fëmijë për arritjen tonë, qeshnim e përqafoheshim në atë moment kur Luto na tha: “u lumtë, tani jeni gati për shfaqje”. Erdhi dhe dita e shumëpritur e shfaqjes. Spektatori na priti mrekullisht me duartrokitjet pa fund dhe tufat e luleve që vinin e vinin pa pushim në skenë. Sigurisht, nuk ishte kollaj të arrihej ai sukses për shkak të pritshmërisë së lartë pas sukseseve të mëparshme. Lot? E kush i fshihte lotët. Kemi qarë, kemi qarë si çiliminj që ç’ke me atë punë. Nga ky moment, ruaj një kujtim të tymuar, kur autori i veprës, Alfred Kanini, ngjitet në skenë dhe tek më dhuronte një tufë me lule më thotë: “Alma bravo, sot më ke emocionuar vërtetë. Me interpretimin tënd ke dhënë personazhin që kam pasur unë në mendje kur e kam shkruar pjesën”. Më besoni, nuk dija ç’të thosha, nuk dija si të reagoja në atë moment. Ky ishte një nder i madh që më bëhej në atë çast. Nëpër dhëmbë, ashtu mes lotësh bel-bëzova vetëm një “faleminderit” dhe lotët vijonin të mos më bindeshin. Që të nesërmen e shfaqjes na erdhi lajmi i shumëpritur. Trupa do të dalë në turne në zonat e jugut të vendit. Unë them me bindje të plotë, vëllezër e motra se për të gjithë ne pjesëtarët e atij grupi teatral, ai turne mbetet një margaritar i çmuar në kujtesën tonë. Fillim korriku 1979. Autobusi i Beharit, shoferi ynë i mrekullueshëm që më pas u bë edhe bashkëshorti i shoqes sonë të grupit, Kostës, qe shumë korrekt. Vijn turne nga qyteti në qytet dhe marrim me vete kënaqësinë e papërshkrueshme të suksesit. Përmeti e Tepelena na kishin pritur më së miri. Ishte data 20 korrik dhe jo pa droje, i drejtohem Lutos: “Më duhet të kthehem në Tiranë për dy ditë, se më martohet motra”. Me gjithë mërzitjen e tij, unë e mora lejen dhe erdha në Tiranë. Ato u bënë tre ditë. Dhe ditën që unë duhet të isha në Delvinë për shfaqjen e radhës, isha ende në Tiranë. Në orën 6 të mëngjesit, nisem me tren për Durrës. Në tren takoj një kolegun tonë, i cili më premti se do të më ndihmonte, pasi unë i qava hallin. Sa zbritëm, menjëherë ai më ndihmoi të hipi në një ‘Zis’ që shkonte për furnizime në Fier. Menjëherë lashë rugën kryesore në Fier dhe dola tek unaza e vogël për ndonjë makinë të rastit, se për autobus nuk bëhej fjalë. Aty dalloj një polic dhe menjëherë i lëshova një ‘breshëri’ sa ai po më shihte i habitur. “Ç’totë mo kjo, aktore, teatër, Delvinë?” Po ai ashtu mes habisë së tij, duke më parë nga koka te këmbët, ndaloj një kamion plot me arka dhe unë pa e zgjatur, hipa në të, teksa polici kish mbetur gojëhapur. Kamioni më çoi deri në Ujin e Ftohtë Tepelenë. Përbrenda ndjeja një lloj gëzimi si fëmijët kur u blen kukullën e parë. Isha afruar

goxha dhe ende ishte mesditë. “Do ia dal”, - i jepja kurajë vetes. Me vrap hyra në lokal dhe pasi hëngra një pilaf me kos, kërkova përgjegjësin. I shpjegoj hallin. Duhet urgjent të shkoj në Delvinë. Ai ishte një njeri i mrekullueshëm. Me makinën e parë më sistemoi për në Sarandë. Tani nisa të fluturoja nga gëzimi, ndonëse e dija furtunën që më priste atje. Ndërkohë që unë i afrohesha Delvinës, Luto kishte mbledhur grupin dhe me ulërima jep ultimatumin: “Kjo është shfaqja e fundit, të dalë si të dalë. Nesër e gjithë trupa për në Karpen. Atje ku gjithë shoqet e shokët kryenin stërvitjen verore”. Të gjithë qenë mërzitur e kishin ulur kokat. As në provën e nxemjes, Luto nuk kishte vajtur. E kishte bërë Fekso që bënte asistent regjisorin. Mbërrita e të gjithë ngazëllenin. Vetëm fytyra e Lutos nxinte. Atë natë e gjithë trupa pati një mobilizim të paparë dhe kemi dhënë një shfaqje të mrekullueshme. Nuk e di a jeni në një mendje me mua, por ajo ka qenë shfaqja më e mirë e atij turne. Publiku qante siç qanim edhe ne në skena apo pas kuintave në momentin kur Majlinda qante vëllain e vrarë. Duartrokitje pa fund. Sukses i jashtëzakonshëm. Luto ngjitet në skenë tejet i mallëngjyer e kjo dukej sheshit, dhe na falënderon një për një. Por dënimin ishte aty pezull, nuk ishte hequr akoma. Të nesërmen, të gjithë kokulur, me ato çantat e bëra gati fare pa kujdes, prisnim të merrnim rrugën e kthimit. U nisëm, por nuk e dinim se për ku... Në autobusin e Beharit mbizotëronte një heshtje varri. Për çudi edhe Behari që nuk e mbyllte gojën, sot e kishte kyçur. Luto vijonte të nxinte si reja me shi. Dhe unë e dija fajtorin. Në ato çaste, kur po i afroheshim Qafë Gjashtës, tek Luto mbërrin një tufë me lule e shkurre. Të gjithë e dinim që kjo ishte vepër e Agim Canit, që udhëtonte me makinën e dekorit të shfaqjes. Zemrat tona rrihnin me vrull.

Unë kisha ulur kokën e nuk e di se sa lot kam derdhur. Përse, përse? Pyesja veten. Aty në Qafë ndahej gjithçka. Për Himarë apo për Karpen. Papritur kumboi zëri i Lutos me nota basi: Behar, majtas për Himarë!

Nuk di ta përshkruaj atë moment, nuk ka fjalë që e përshkruan. Të gjithë si me komandë brofën në këmbë.

- Urra, urra dhe lumë urimesh për Luto...

Për fat të keq në Himarë nuk gjetëm hotel. Por kush pyeste. Gëzimi ynë shkonte përtej një dhome hoteli. E kaluam natën aty buzë detit me këngë e dashuri për njëri tjetrin. Ne vajzat e teatrit u bëmë si vajza e valëve tek prisnim të nesërmen më të bukur...

Kështu mbyllet ky takim. Ishte dhjetor. mot i vranët e i ftohtë. Por ne nuk e ndjenim. Ne ndjenim në gjokse zjarrin e ndezur në ato vite. Unë kisha përgatitur një poezi posaçërisht për atë takim, të cilën po e ndaj me ty i dashur lexues:

Tok me pranverën, vijnë edhe dallëndyshe, Harlisen pemët në ngjyrat e ylberit, Bulojnë sythet dhe lulet shumëngjyrëshe, Bukurinë ia shton edhe kënga e bilbilit.

Edhe kujtimet vijnë ëmbël valë-valë, Në secilën pranverë të jetës sonë. Para syve tanë parakalojnë si në paradë, Për thinja tona më e bukura metaforë. Se pranverë ishte atëherë, prag-behar, Kur mbollëm një lulëkuqe në atë vatër.

Kur bënim filozofi, taktikë dhe zjarr, Ne ditëm të bëjmë edhe teatër. Dhe mbeti aty, e bukura lulëkuqe, E brishtë, e butë e sfiduese si ajo. Si relike e vyer e asaj kohe me huqe, Por tharmi, tharmi i jetës ende gjallon.

Nga Sali Frangu

Raporti Strategjik i Parashikimit 2022

Binjakëzimi i tranzicionit të gjelbër dhe atij dixhital në kontekstin e ri gjeopolitik

Komisioni ka miratuar Raportin Strategjik të Parashikimit 2022, "Binjakëzimi i tranzicionit të gjelbër dhe dixhital në kontekstin e ri gjeopolitik". Ndërsa përgatitimi për të përshpejtuar të dy tranzicionet, raporti identifikon dhjetë fusha kyçe të veprimit me objektivin e maksimizimit të sinerjiave dhe konsistencës midis klimës dhe ambicieve tona dixhitale. Duke vepruar kështu, BE-ja do të forcojë qëndrueshmërinë e saj ndërsektoriale dhe do të hapë autonominë strategjike dhe do të jetë më e përgatitur për t'u përballur me sfidat e reja globale nga tani deri në vitin 2050.

Maroš Šefčovič, nënkryetar për marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe largpamësinë tha: "Për të arritur neutralitetin e klimës deri në vitin 2050, ne duhet të çlirojmë fuqinë e dixhitalizimit. Në të njëjtën kohë, qëndrueshmëria duhet të jetë në qendër të transformimit dixhital. Kjo është arsyeja pse ky Raport Strategjik i Parashikimit hedh një vështrim më të thellë se si t'i përfaqësojmë më së miri objektivat tona binjake, veçanërisht pasi ato marrin një dimension të rëndësishëm sigurie për shkak të ndryshimeve aktuale gjeopolitike. Për shembull, nga viti 2040, riciklimi mund të jetë një burim kryesor i metaleve dhe mineraleve, i pashmangshëm për teknologjitë e reja, nëse Europa rregullon mangësitë e saj në fushën e lëndëve të para. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi midis tranzicioneve binjake, ndërkohë që përpiqet për autonomi të hapur strategjike, është rruga e duhur përpara."

Tranzicioni i gjelbër dhe ai dixhital janë në krye të agjendës politike të Komisionit të përcaktuar nga presidenti von der Leyen në 2019. Në dritën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, Europa po përshpejton përqafimin e saj të klimës dhe udhëheqjes dixhitale globale, me sytë e vendosur në sfidat kryesore, nga energjia dhe ushqimi, tek mbrojtja dhe teknologjitë më të avancuara. Nga ky këndvështrim, Raporti Strategjik i Parashikimit 2022 parashtron një analizë të orientuar drejt së ardhmes dhe gjithëpërfshirëse të ndërveprimeve midis tranzicioneve binjake, duke marrë parasysh rolin e teknologjive të reja dhe ato në zhvillim, si dhe faktorët kryesorë gjeopolitikë, socialë, ekonomikë dhe rregullatorë që formojnë binjakëzimin, d.m.th aftësi e tyre për të përforcuar njëri-tjetrin.

Teknologjitë thelbësore për binjakëzimin drejt vitit 2050

Nga njëra anë, teknologjitë dixhitale ndihmojnë BE-në të arrijë neutralitetin e klimës, të reduktojnë ndotjen dhe të rivendosë biodiversitetin. Nga ana tjetër, përdorimi i gjerë i tyre po rrit konsumin e energjisë, duke çuar gjithashtu në më shumë mbetje elektronike dhe gjurmë më të mëdha mjedisore.

Energjia, transporti, industria, ndërtimi dhe bujqësia, pesë emetuesit më të mëdhenj të gazit serrë në BE, janë çelësi për një binjakëzim të suksesshëm të tranzicionit të gjelbër dhe atij dixhital. Teknologjitë do të luajnë një rol kyç në reduktimin e gjurmës së karbonit të këtij sektori. Deri në vitin 2030, shumica e reduktimeve në emetimet e CO2 do të vijnë nga teknologjitë e disponueshme sot. Megjithatë, arritja e neutralitetit dhe qarkullimit të klimës deri në vitin 2050 do të mundësohet nga teknologjitë e reja aktualisht në



fazën eksperimentale, demonstruese ose prototip.

Për shembull: Në sektorin e energjisë, sensorë të rinj, të dhëna satelitore dhe blockchain mund të ndihmojnë në forcimin e sigurisë energjetike të BE-së, duke përmirësuar parashikimin e prodhimit dhe kërkesës për energji, duke parandaluar ndërprerjet e lidhura me motin ose duke lehtësuar shkëmbimet ndërkufitare.

Në sektorin e transportit, një gjeneratë e re e baterive ose teknologjive dixhitale, si inteligjenca artificiale dhe interneti i gjërave, do të mundësojë zhvendosje të mëdha drejt qëndrueshmërisë dhe lëvizshmërisë multimodale në mënyra të ndryshme transporti, madje edhe në aviacionin në distanca të shkurtra.

Në të gjithë sektorët industrialë, binjakët dixhitalë, një homolog virtual i një objekti ose procesi fizik, duke përdorur të dhëna në kohë reale dhe mësimin e makinerive, mund të ndihmojnë në përmirësimin e dizajnit, prodhimit dhe mirëmbajtjes.

Në sektorin e ndërtimit, modelimi i informacionit të ndërtesave mund të përmirësojë efikasitetin e energjisë dhe ujit, duke ndikuar në zgjedhjet e projektimit dhe përdorimin e ndërtesave.

Së fundi, në sektorin e bujqësisë,

llogaritja kuantike, në kombinim me bioinformatikën, mund të përmirësojë të kuptuarit e proceseve biologjike dhe kimike të nevojshme për të reduktuar pesticidet dhe plehrat.

Faktorët gjeopolitikë, socialë, ekonomikë dhe rregullatorë që ndikojnë në binjakëzimin.

Paqëndrueshmëria aktuale gjeopolitike konfirmon nevojën për të përshpejtuar jo vetëm tranzicionet binjake, por edhe për të reduktuar varësitë tona strategjike. Në afat të shkurtër, kjo do të vazhdojë të ndikojë në çmimet e energjisë dhe ushqimeve, me pasojat të konsiderueshme sociale. Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, për shembull, aksesin e qëndrueshëm në lëndët e para kritike për tranzicionet binjake do të mbetet i një rëndësie të madhe, duke shtuar presionin për të kaluar në zinxhirët e furnizimit më të shkurtër dhe më pak të cenueshëm dhe për të mbështetur miqësi kudo që të jetë e mundur.

Binjakëzimi do të kërkojë gjithashtu varjen e modelit ekonomik të BE-së për mirëqenien, qëndrueshmërinë dhe qarkullimin. Pozicioni i BE-së në formësimin e standardeve globale do të luajë një rol të rëndësishëm, ndërsa drejtësia sociale dhe axhenda e aftësive do të jenë ndër kushtet për sukses, krahas mobilizimit të investimeve publike dhe

private. Pritet që pothuajse 650 miliardë euro do të nevojiten për investime shtesë të qëndrueshme në të ardhmen çdo vit deri në vitin 2030.

Dhjetë fusha kryesore të veprimit

Raporti identifikon fushat ku nevojitet një përgjigje politike për të maksimizuar mundësitë dhe për të minimizuar rreziqet e mundshme që rrjedhin nga binjakëzimi:

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe autonomisë së hapur strategjike në sektorë kritikë për tranzicionet binjake nëpërmjet, për shembull, punës së Observatorit të BE-së për Teknologjitë Kritike, ose Politikës së Përbashkët Bujqësore në garantimin e sigurisë ushqimore.

Rritja e diplomacisë së gjelbër dhe dixhitale, duke shfrytëzuar fuqinë rregullatore dhe standardizuese të BE-së, duke promovuar vlerat e BE-së dhe duke nxitur partneritetet.

Menaxhimi strategjik i furnizimit të materialeve dhe mallrave kritike, duke adoptuar një qasje sistematike afatgjatë për të shmangur një kurth të ri varësie.

Forcimi i kohezionit ekonomik dhe social, për shembull, duke përforcuar mbrojtjen sociale dhe shtetin e mirëqenies, me strategjitë e zhvillimit rajonal dhe investimet që luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm.

Përshtatja e sistemeve të arsimit

dhe trajnimit për t'iu përshtatur një realiteti teknologjik dhe socio-ekonomik që transformohet me shpejtësi, si dhe mbështetja e lëvizshmërisë së punës në të gjithë sektorët.

Mobilizimi i investimeve shtesë për të ardhmen në teknologji dhe infrastruktura të reja dhe veçanërisht në K&I dhe sinerjitë midis kapitalit njerëzor dhe teknologjisë, me projekte ndërvendore kyçe për bashkimin e burimeve të BE-së, kombëtare dhe private.

Zhvillimi i kornizave monitoruese për matjen e mirëqenies përmes PBB-së dhe vlerësimi i efekteve mundësuese të dixhitalizimit dhe gjurmës së tij të përgjithshme të karbonit, energjisë dhe mjedisit.

Sigurimi i një kuadri rregullator të sigurt për tregun e vetëm, i favorshëm për modelet e qëndrueshme të biznesit dhe modelet e konsumatorit, për shembull, duke reduktuar vazhdimisht barrën administrative, duke përditësuar kutinë tonë të politikave të ndihmës shtetërore ose duke aplikuar inteligjencën artificiale për të mbështetur politikëbërjen dhe angazhimin e qytetarëve.

Ngritja e një përqasjeje globale për vendosjen e standardeve dhe përfitimi nga përparësia e parë lëvizëse e BE-së në qëndrueshmërinë konkurruese, e përqendruar rreth parimit të "zvogëlimit, riparimit, ripërdorimit dhe riciklimit".

Promovimi i sigurisë kibernetike të fuqishme dhe kuadri i sigurt i ndarjes së të dhënave për të siguruar, ndër të tjera, që entitetet kritike mund të parandalojnë, rezistojnë dhe rikuperojnë ndërprerjet, dhe në fund, të krijojnë besim në teknologjitë e lidhura me tranzicionet binjake.

Hapat e ardhshëm

Komisioni do të vazhdojë të avancojë Agjendën e tij Strategjike të Parashikimit, duke informuar nismat e Programit të Punës të Komisionit për vitin e ardhshëm.

Më 17-18 nëntor 2022, Komisioni do të bashkëorganizojë konferencën vjetore të Strategjisë Europiane dhe Sistemit të Analizës Politike (ESPAS) për të diskutuar konkluzionet e Raportit Strategjik të Parashikimit 2022 dhe për të përgatitur terrenin për edicionin e vitit 2023.



Një shëndet: Komisioni mirëpret mbështetjen e Shteteve Anëtare për të përcaktuar antimikrobikët e rezervuar për njerëzit

Shtetet Anëtare kanë dhënë mbështetjen e tyre për krijimin e një liste që përcakton antimikrobikët që do të rezervohen ekskluzivisht për trajtimin e disa infeksioneve të njerëzimit. Kjo do të thotë se këta antimikrobikë nuk mund të përdoren të kafshët në asnjë rrethanë. Shitja e produkteve medicinale veterinarë që përmbajnë këta antimikrobikë do të ndalohej. Përmes kësaj mase, BE-ja ruan efikasitetin e antimikrobikëve që janë të një rëndësie të madhe për shëndetin e njeriut. Miratimi i sotëm nga Shtetet Anëtare është një moment historik i vërtetë në luftën e BE-së kundër rezistencës antimikrobike (AMR). Stella Kyriakides, Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore tha: "AMR është një pandemi e heshtur dhe adresimi i saj ka qenë një prioritet që nga fillimi i mandatit tim. Lista e votuar sot, e para e këtij lloji në BE dhe një pikë referimi në mbarë botën, është një hap i madh përpara në qasjen tonë të politikës së një shëndeti për të frenuar

rezistencën antimikrobike. Është një shembull kryesor se si ne trajtojmë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe shëndetit të bimëve së bashku, duke marrë në të njëjtën kohë edhe rëndësinë e mjedisit. Mbështetja e marrë sot nga Shtetet Anëtare ilustron se BE-ja qëndron në ballë të luftës kundër AMR dhe se është e vendosur të ndërmarë veprime pioniere në këtë drejtim". Antimikrobikët e listuar në këtë akt ligjor janë caktuar në bazë të këshillave shkencore të ofruara nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA), në bashkëpunim me ekspertë nga shtetet anëtare të BE-së, nga Qendra Europiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) dhe BE-së për Ushqimin. Autoriteti i Sigurisë (EFSA). Më shumë se 30 shkencëtarë, duke përfshirë mikrobiologë, veterinerë dhe mjekë me ekspertizë në sëmundjet infektive, kontribuan në këtë vlerësim shkencor. Komisioni do të miratojë zyrtarisht listën në javët e ardhshme. Lista fillon të zbatohet 6 muaj pas publikimit të saj, i cili pritet të bëhet gjatë verës.

"Curiosity" i NASA-s kap pamje mahnitëse të një peizazhi të Marsit në ndryshim


Formacionet mahnitëse shkëmbore të dokumentuara nga roveri ofrojnë dëshmi të një klime të tharjes në të kaluarën e lashtë të Planetit të Kuq.

Gjatë vitit të kaluar, roveri "Curiosity Mars" i NASA-s ka udhëtuar nëpër një zonë tranzicioni nga një rajon i pasur me argjilë në një zonë të mbushur me një mineral të kripur të quajtur sulfat. Ndërsa ekipi shkencor synoi rajonin e pasur me argjilë dhe atë të ngarkuar me sulfate për prova që secili mund të ofrojë për të kaluarën ujore të Marsit, zona e tranzicionit po rezultoi të jetë gjithashtu magjepsëse shkencërisht. Në fakt, ky tranzicion mund të sigurojë regjistrimin e një ndryshimi të madh në klimën e Marsit miliarda vjet më parë që shkencëtarët sapo kanë filluar ta kuptojnë.

Mineralet e argjilës u formuan kur liqenet dhe përrrenjtë dikur valëviteshin nëpër kraterin Gale, duke depozituar sedimente në atë që tani është baza e malit Sharp, mali 3 milje i gjatë (5 kilometra i lartë) rrëzë kodrave të të cilit "Curiosity" është ngjitur që nga viti 2014. Më i lartë në malin në zonën e tranzicionit, vëzhgimet e roverit "Curiosity" tregojnë se përrrenjtë u thanë në rrjedha dhe dunat e rrës u formuan mbi sedimentet e liqenit.

"Ne nuk i shohim më depozitat e liqenit që i pamë për vite më poshtë në malin Sharp", -thotë Ashwin Vasavada, shkencëtar i projektit të "Curiosity" në Laboratorin "Jet Propulsion" të NASA-s në Kaliforninë Jugore. "Në vend të kësaj, ne shohim shumë prova të klimave më të thata, si dunat e thata që herë pas here kishin përrrenj që rridhnin rreth tyre. Ky është një ndryshim i madh nga liqenet që vazhduan ndoshta për miliona vjet më parë."

Ndërsa roveri ngjitet më lart përmes zonës së tranzicionit, ai po zbulon më pak argjilë dhe më shumë sulfate. "Curiosity" së shpejti do të shpojë mostrën e fundit shkëmbore që do të marrë në këtë zonë, duke ofruar një vështrim më të detajuar në ndryshimin e përbërjes minerale të këtyre shkëmbinjve.



Roveri "Curiosity Mars" i NASA-s kapi këtë panoramë 360 gradë pranë një lokacioni me nofkën "Sierra Maigualida", më 22 maj 2022, ditën e 3481-të marsiane, ose sol, të misionit. Panorama përbëhet nga 133 imazhe individuale të kapura nga Kamera "Mast" e "Curiosity". Burimi: NASA/JPL-Caltech/MSSS

Në këtë zonë dallohen edhe veçori unike gjeologjike. Kodrat në zonë me gjasë filluan në një mjedis të thatë me duna rëre të mëdha, të rrëmyera nga era, duke u forcuar në shkëmb me kalimin e kohës. Në mbetjet e këtyre dunave janë gërshetuar sedimente të tjera të bartura nga uji, ndoshta të depozituara në pellgje ose përrrenj të vegjël që dikur endeshin midis dunave. Këto sedimente tani shfaqen si pirgje shtresash rezistente ndaj erozionit, si ajo me nofkën "The Prow" (Lundrimi).

Duke e bërë historinë më të pasur dhe më të komplikuar është njohuria se ka pasur periudha të shumta në të cilat ujërat nëntokësore u zbehën dhe rridhnin me kalimin e kohës, duke lënë një grumbull



Roveri "Curiosity Mars" i NASA-s kapi këtë pamje të një rajoni që përmban sulfate, duke përdorur kamerën e tij, ditën e 3462-të marsiane, ose sol, të misionit. Gurët e errët që shihen pranë qendrës mendohet se janë formuar nga rëra e depozituar në përrrenj ose pellgje antike. Burimi: NASA/JPL-Caltech/MSSS



Roveri "Curiosity Mars" i NASA-s kapi këtë pamje të shkëmbinjve të shtresuar dhe të krisur që besohet se janë formuar në një shtrat të lashtë përroi ose pellg të vogël. Gjashtë imazhet që përbëjnë këtë mozaik u kapën duke përdorur Mastcam, më 2 qershor 2022, ditën e 3492-të marsiane, ose sol, të misionit. Burimi: NASA/JPL-Caltech/MSSS

pjesësh enigmë për shkencëtarët e "Curiosity" për t'u mbledhur në një afat kohor të saktë.

Dhjetë vjet më vonë, duke vazhduar fuqishëm

"Curiosity" feston vitin e tij të 10-të në Mars. Ndërsa roveri po tregon moshën e tij pas një deкаде të plotë eksplorimi, asgjë nuk e ka penguar atë të vazhdojë ngjitjen e tij.

Më 7 qershor, "Curiosity" kaloi në modalitetin e sigurt pasi zbuloi një lexim të temperaturës në një kuti kontrolli instrumentesh brenda trupit të roverit që ishte më i ngrohtë se sa pritej. Modaliteti i sigurt ndodh kur një anije kozmike ndjen një problem dhe mbyll automatikisht të gjitha funksionet e saj, përveç atyre më thelbësore, në mënyrë që inxhinierët të mund të vlerësojnë situatën.

Megjithëse "Curiosity" doli nga modaliteti i sigurt dhe u kthye në funksionimin normal dy ditë më vonë, inxhinierët e JPL janë ende duke analizuar shkakun e saktë të problemit. Ata dyshojnë se modaliteti i sigurt u aktivizua pasi një sensor i temperaturës dha një matje të pasaktë dhe nuk ka asnjë shenjë se do të ndikojë

Roveri "Mars Curiosity" i NASA-s kapi prova të shtresave që u krijuan si rërë e fryrë nga era e grumbulluar dhe u fshi në një vend të quajtur "Las Claritas". Ky imazh u shkrep duke përdorur "Mastcam", më 19 maj 2022, në ditën e 3478-të marsiane, ose sol, të misionit. Burimi: NASA/JPL-Caltech/MSSS

ndjeshëm në funksionimin e roverit pasi sensorët rezervë të temperaturës mund të sigurojnë që elektronika brenda trupit të roverit të mos nxeht shumë. Rrotat e aluminit të roverit po tregojnë gjithashtu shenja konsumimi. Më 4 qershor, ekipi inxhinierik urdhëroi reverin "Curiosity" të bënte fotografi të reja të rrotave të tij, diçka që kishte bërë çdo 1000 metra për të kontrolluar gjendjen e tyre të përgjithshme.

Ekipi zbuloi se rrota e mesme e majtë kishte dëmtuar një nga gërvishtjet e saj, hapat zig-zag përgjatë rrotave të "Curiosity". Kjo rrotë e veçantë tashmë kishte katër gërvishtje të thyera, kështu që tani pesë nga 19 gërmimet e saj janë thyer.

Gruazat e dëmtuara më parë tërhoqën vëmendjen në internet kohët e fundit sepse një pjesë e "lëkurës" metalike mes tyre duket se ka rënë nga timoni në muajt e fundit, duke lënë një boshllëk.

Ekipi ka vendosur të rrisë imazhin e rrotave të tij në çdo 500 metra, një kthim në kadencën origjinale. Një algoritëm i kontrollit të tërheqjes kishte ngadalësuar konsumimin e rrotave mjaftueshëm për të justifikuar rritjen e distancës midis imazhit.

"Ne kemi vërtetuar përmes testimit në tokë se mund të vozisim në mënyrë të sigurt në timonin e rrotave nëse është e nevojshme", - tha Megan Lin, menaxherja e projektit të "Curiosity" në JPL. - Nëse do të arrijmë ndonjëherë në pikën që një rrotë e vetme të kishte thyer shumicën e gërvishtjeve të saj, ne mund të bënim një thyerje të kontrolluar për të hedhur pjesët që kanë mbetur. Për shkak të tendencave të fundit, duket e pamundur që ne të kemi nevojë të ndërmarrim një veprim të tillë. Rrotat po mbajnë mirë, duke siguruar tërheqjen që na nevojitet për të vazhduar ngjitjen tonë."

Plisi, kjo kapelë që e shihni çdo ditë e më rrallë mbi kokat e gjyshërve, vazhdon të këtë rëndësi të veçantë dhe simbolika e tij nuk është zbehur. Megjithatë, Plisi ka edhe disa karakteristika të cilat ndoshta nuk i keni ditur!



PLISI

Kapela me të cilën identifikohen shqiptarët, plisi, është trashëguar që nga kohët pellazgo-ilire. Për qindra vjet, me kapelën e bardhë mbi krye shqiptarët janë dalluar nga të tjerët. Shumë historianë e shpjegojnë faktin se plisi ka pasur rol të dyfishtë dhe është parë si diçka më shumë se thjesht një kapelë.

Plisi, kjo kapelë që e shihni çdo ditë e më rrallë mbi kokat e gjyshërve, vazhdon të këtë rëndësi të veçantë dhe simbolika e tij nuk është zbehur. Megjithatë, Plisi ka edhe disa karakteristika të cilat ndoshta nuk i keni ditur!

Plisi duhet të ruhet gjithmonë i bardhë, si nderi

Për shqiptarët, përveç përdorimit praktik, plisi shpreh edhe krenarinë kombëtare.

Dikur është përdorur për t'u mbrojtur nga të ftohtit, shiu e dielli i fortë.

Mirëpo, plisi shpreh edhe krenarinë kombëtare, qëndresën, mosnënshtrimin ndaj pushtuesve të shumtë, pastërtinë morale si dhe ndershmërinë e popullit tonë.

Të moshuarit, që e kanë bartur qysh nga mosha e fëmijërisë theksojnë faktin se pavarësisht rrethanave, një burrë shqiptar duhet të jetë i kujdesshëm që plisi mbi kokën e tij të jetë gjithmonë i bardhë.

Edhe në rastet kur nuk mund të blihet një i ri, ai duhet të pastrohet në mënyrë konstante.

Bardhësia shkon përtej simbolit të pastërtisë, sepse tregon edhe ndershmërinë e burrit shqiptar.

Një kapele me shumë emra

Ka mundësi që kur flisni për plisin përdorni fjalë të tjera si kësulë, qylah, qylaf, qeleshe, kapiçë etj. Secili nga emërtimet varion nga cila krahinë e trojeve shqiptare vini. Megjithatë, emërtimi kryesor, 'Plis' rrjedh nga gjuha e vjetër greke 'pilos', që do të thotë kapelë e zbrazët apo boshe.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe fjala plis ka kuptimin e një cope jo të endur, por që bëhet me lesh të shkelur mirë dhe të larë disa herë me sapun.

Punimi i plisit, art më vete

Qeleshepunues quhen të gjithë ata zejtarë që merren me punimin e plisit. Duke filluar që nga leshi që quhet cohë, e deri në formën finale, atë të kapelës së rrumbullakët. Dikur çdo çarshi e çdo qyteti shqiptar kishte të paktën një të tillë, por kjo gjë tashmë ka ndryshuar.

Punëtorët e dyqaneve të qeleshepunuesve hasen çdo ditë e më rrallë. Këtë zejtarë vazhdojnë ta ruajnë vetëm ata që e kanë traditë familjare.

Si proces, punimi i plisit nuk është aspak i lehtë. Ai nis nga tjerja e leshit, pastrimi me sapunë e deri të formësimi final. Është një punë që kërkon edhe forcë fizike por edhe përkushtim deri në detaj.

Arenat sportive, e ardhmja dhe plisi

Ndonëse çdo ditë e më pak e shohim tek burrat shqiptarë në përditshmëri, plisin apo qeleshe shohim sa herë ka ndeshje sportive.

Sipas dokumenteve, arkivave, që edhe sot ruhen në muze të ndryshëm të botës, plisi është përdorur ndoshta 2 mijë vjet p.e.s... Plisi për ne shqiptarët ka rëndësi të veçantë, pasi paraqet identitetin tonë kombëtar dhe autoktoninë tonë në këto troje ku jetojmë. Sipas studiuesve, përdorimi i Plisit ka qenë i domosdoshme për të gjithë meshkujt duke filluar nga mosha e hershme e djalërisë madje ata që nuk e përdornin plisin u quanin njerëz pa vlerë.

"Plisi përpara ka qenë një rekuizitë e domosdoshme për çdo mashkull prej moshës rinore deri në shkuarjen nga kjo jetë. Njeriu kur ka dalë pa plis në kokë ka qenë i turpëruar... Njeriu për të



pasur dinjitet është dashur të ketë plisin në kokë", - shpjegon historiani Muhamet Rugova.

Plisi e mori emrin kështu nga se krijohet prej leshit të deleve të bardha, në forma të ndryshme që bëjnë pjesë në veshjen tradicionale shqiptare.

Karakteristike ka qenë që në Rrafshin e Dukagjinit dhe Shqipërinë veriore janë përdorur plis të rrumbullakët. Nga Dibra dhe Tirana nga lart kanë qenë të rrafshuar. Ndërsa në Shqipërinë e jugut kanë qenë pak më të zgjatur dhe me një

maje lartë që edhe sot i mbajnë në ansamble. Kryesisht kanë qenë nga leshi i dhenve.

Plisi i Shqiptarëve të veriut ka formën e rrumbullakët, pa ndonjë shtesë tjetër.

Në gjenezën e plisit, sipas entomologjisë, në botimin e John Wilkes në veprën e tij "Ilirët" (Split, në vitin 2001), ku përmend ndër të tjerash se në relievin e varreve në Livna, në mes të Dalmacisë, shihen në mesin e kapelave të ngushta, edhe kapela e njohur e Ballkanit (qeleshja shqiptare) që shfaqet në relievin e Zenicës".

Nga dokumentet e kohës, në vitin 1715, feldmarshalli prusian Schulenburg, i këshillonte autoritetet veneciane që ta bazonin ushtrinë e tyre tek elementi shqiptar: edhe në rast se do duhej të rekrutonin ushtarë nga kombësi të tjera, këta duhet të mbanin kapele shqiptare.


Historia e Plisit

Fjala "Plis" në gjuhën shqipe emërton një copë dheu, që shpesh përdoret kur hapet brazda për

mbjellje apo ndonjë punim tjetër. Kur filloi të punohej toka dhe të mbilleshin bimët e egra, që shënoi lindjen e agrikulturës (afro para 7-8000 vjetësh) dhe vendbanimeve të përhershme, atëherë ka lindur edhe hyjnizimi i dheut. Etruskët e Tarkuinës (Tarquinia, Itali), një fis pellazg, e shikonin fatin e tyre tek plisi i një toke të punuar në orët e para të mëngjesit. Siç pohon albanologu Hahn (Johann Georg von Hahn, 1811-1869): "Pellazgët e kohës para-historike, ishin bujq të mirë, mjeshtër të zotë dhe tek ata kulti fetar ishte mjaft i zhvilluar". Është interesant një e dhënë e Hahn-it: "Më duket se kam këndue te një vjershëtor i vjetër, se krijesa e parë e botës asht delja, e cila ka dalë nga Toka".

Në objektet arkeologjike shohim artefakte që iu blatoreshin Perëndive, që mbanin mbi kokë një copë dheu-Plisin. Për ta bërë më të qartë simbolin mitik, kjo pjesë lyhej me bojë e zezë. Me këtë "shenjë" dëshmonin përkatësinë e fisit të tyre "të lindur prej dheut" pra, prej fiseve pellazge. Forma konike si e fëmijëve të Zeusit, binjakëve Dioskurë apo e Aleksandrit të Madh, është ruajtur tek shqiptarët e sotëm të zonës së Labërisë dhe Çamërisë (Molosia e lashtë). Në skulpturën e Perëndisë tokësore Serapi, Plisi (dheu) është i zburkruar me bimë; tek Perëndësia Astarte, copa "e dheut" ka formën cilindrike, e cila është forma e qeleshe me e përhapur tek popullsia shqiptare. Sot e gjejmë si mbulesë të kokës, po në ngjyrë të zezë edhe tek priftërinjtë e Kishës ortodokse.

Vendosja e copës së dheut mbi kokë, ishte një ide e njeriut primitiv që e praktikonte mbi artefaktet prej balte, të cilat lireshin në altarë apo vende të shenjta. Praktikisht, njeriu e vendosi mbi kokë shumë më vonë, në kohën kur mësoi ta përpunojë leshin e deles (kur filloi artizanati) gjithmonë për të treguar origjinën e tij, hyjnore. Gjurmët më të lashta të përdorimit të qeleshe, janë gjendur në mijëvjeçarin e III-të para Krishtit.





NGA SALI ONUZI

LABINOT, 10 KORRIK 1943: SHTAB MADHOR DHE USHTRI NACIONALÇLIRIMTARE

Për të fituar duhej një Ushtri, jo disa çeta. Për të pasur një ushtri duhej një organ drejtues e komandues. Ky do të ishte Shtabi Madhor i LANÇ. Ish përmendur që në Konferencën e Pezës, 80 vjet më parë, ish vendosur që kjo ushtri të ngrihej në Konferencën e parë të vendit në mars 1943 në Labinot. Deri në korrik kishin kaluar 4 muaj. Numri i partizanëve në çeta e batalione kishte shkuar në 20 mijë.

Çfarë pritej për Shtabin Madhor?

Siç del nga dokumentet, Partia Komuniste (Enver Hoxha, Ymer Dishnica, etj.) po prisnin edhe Ballin në luftë (zogistët, së paku formalisht kishin hyrë me Abaz Kupin e ndonjë aksion). Aleatët perëndimorë dhe kominterni kërkonin jo thjesht një front nacionalçlirimtar, por një front të bashkuar nacionalçlirimtar. Ky duhej të përfshinte gjithë forcat politike dhe ushtarake, gjithë fuqitë e armatosura. Në themelimin e saj, PKSH kishte vendosur që krijimin e ushtrisë ta realizonte në bashkëpunim edhe me parti të tjera politike dhe lëvizjen nacionalçlirimtare (Rezolucioni i themelimit të PKSH-së. “PPSH, Dokumente kryesore, vëllimi 1, Tiranë 1971, f.25.)

Por Balli Kombëtar po vonohej. Kriza e situatës së pushtesit dhe faktorë të tjerë çuan në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist NÇ në Labinot, më 4 korrik 1943. Këtë e kishte bërë emergjente edhe arritja në Labinot e një misioni ushtarak britanik me në krye Bill Maklin, ku priste të takohej me një autoritet përfaqësues ushtarak në shkallë kombëtare për të biseduar për bashkëpunimin dhe ndihmën aleate.



Më 4 korrik, Këshilli i Përgjithshëm zgjodhi me votim 12 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm: Enver Hoxhën, Spiro Moisiun, Ramadan Çitakun, Haxhi Lleshin, Dali Ndreun, Mustafa Xhanin, Abaz Kupin, Myslym Pezën, Mustafa Gjinishin, Ymer Dishnicën, Sejfulla Maleshovën dhe Bedri Spahiun. Politikanë dhe ushtarakë profesionistë, nga të gjitha rajonet e vendit, komunistë dhe të pa parti. Ky Shtab e merrte besimin dhe statusin e tij direkt nga Këshilli i Përgjithshëm NÇ, duke qenë kështu një komandë e përbashkët ushtarake me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta. Për efekt drejtimi të tij Shtabi zgjodhi më datë 5 korrik kryetarin (komandantin), major Spiro Moisiun dhe komisar politik, Enver Hoxhën.

Shqipëria kish pasur përvojën e saj të ngritjes e të funksionimit të Shtabit Madhor, e para në vitet 1913-1914, dhe e dyta nga 1920 më 1939. Në të dy herët Shqipëria kish dështuar. Herën e parë për shkak të ndërhyrjes së rëndë e të padrejtë të ndërkombëtarëve (Komisioni



Ndërkombëtar i kontrollit) që ndërprente veprimtarinë e Qeverisë së përkohshme të Vlorës dhe herën e dytë me dështimin e Shtabit Madhor shqiptar, për arsye politike (kapitullimi i mbretit etj.) në prill 1939.

Ky që po krijohet, më 4 korrik 1943, do të mbante po atë titull, Shtabi Madhor i Luftës, për kohëzgjatësi do të kishte në krye po një major (si më 1913), do të thyente traditat klasike duke futur në Shtab edhe civilë dhe ushtarakë. Por ky Shtab Madhor ndryshe nga dy të parët do ta çonte Shqipërinë në fitore, në çlirim të saj nga pushtuesit nazifashistë.

Në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u aktivizuan edhe shume oficerë patriotë të ushtrisë monarkiste, të përgatitur në shkollat ushtarake brenda dhe jashtë vendit, në Itali. Këta sollën përvojën e tyre në organizimin e Shtabit dhe në funksionimin e tij (pastaj dhe të Ushtrisë). Ndryshe siç pat ndodhur në ushtrinë partizane jugosllave, ku Shtabi i përgjithshëm më 1941 u ngrit me 10

punëtorë “proletarë” (asnjë ushtarak) dhe ata për një kohë të shkurtër jo vetëm që nuk drejtuan, por u vranë edhe vetë, duke dhënë shembullin e tyre proletar në vijën e parë. Pas këtij dështimi ftuan për të kryesuar Shtabin e Përgjithshëm të



Enver Hoxha, komisar i Shtabit Madhor, me disa anëtarë të Shtabit dhe oficerë të misionit ushtarak britanik në Labinot, korrik 1943.

ushtrisë partizane jugosllave një kapiten malazez (Arso Jovanović), ish-oficer i ushtrisë monarkiste që kish dalë malit me një çetë antifashiste.

Më datë 9 korrik Shtabi Madhor shqiptar i Luftës NÇ diskutoi dhe miratoi Planin e bashkëpunimit që do t’u paraqitej aleatëve britanikë, që ishte dokumenti i parë madhor i tij në aspektin strategjik. Aty parashikohej se ç’forca mund të ngrinte çdo krahinë, sa armë duheshin, sa municion etj., për secilën prej tyre. Dhe kjo iu paraqit

misionit britanik më datë 10 korrik 1943, atë ditë që u shpall publikisht krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Luftës NÇ.

Po më 9 korrik, Këshilli i Përgjithshëm në proklamatin e tij ftonte Ballin Kombëtar në bisedime me shpresë se ky do të hynte në luftë, madje edhe në përbërjen e Shtabit Madhor (ku ishin lënë vende rezervë). Po Balli Kombëtar nuk donte të hynte në Frontin Nacionalçlirimtar, e rrjedhimisht as në Shtabin madhor. Sepse Balli nuk ia delte dot të konkurronte Partinë Komuniste në këto institucione të Luftës (Këshilli, Shtab etj.), për shkak të popullaritetit të madh që kishte fituar Partia Komuniste dhe Fronti NÇ. Bali Kombëtar donte një Shqipëri nën sundimin e tij. Në Konferencën e Mukjes, Balli u përpoq t’i sfidonte organizmat e krijuar deri

ushtri e rregullt. Shtabi do ta udhëhiqte atë dhe do të ngrinte popullin në luftë, do të krijonte Brigada sulmuese, Shtab operativ dhe shtabet e qarqeve.

Kjo ushtri do të përballonte operacionin e rëndë të Dimrit 1943-44, dhe në pranverë do të gjallërohej e hidhej në mësymje. Në këtë dimër Shtabi i Përgjithshëm dhe ushtria partizane vullnetare NÇ kaluan një provë të vështirë. Komanda e tij mbeti e rrethuar për disa javë në Çermenikë-Shëngjergj-Martanesh, po ndërkohë pjesa tjetër e Shtabit ndodhej në krye të detyrës, në zona lufte, në Korçë (Haxhi Leshi) në Berat (Ramadan Çitaku,) në Pezë, (Myslym Peza), në Gjirokastrë (Bedri Spahi) etj., të cilët komanduan dhe drejtuan, duke treguar ndjenjë përgjegjësie e iniciativë. Drejtimi dhe komandimi i Ushtrisë dhe njësitë të saj nuk u ndërpre, ashtu si dhe krijimi i brigadave të reja.

Kongresi i Përmetit, 24-28 maj 1944, është një etapë shumë e rëndësishme në historinë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ky Kongres caktoi postin e komandantit të përgjithshëm (gjeneral kolonel Enver Hoxha) votoi Shtabin e Përgjithshëm, (shef i Shtabit madhor, gjeneralmajor Spiro Moisiu), vuri gradat në ushtri, urdhëroi krijimin e njësitë të mëdha, divizion e korparmata. Në zbatim të vendimeve të tij, Ushtria NÇ përballoi operacionin e qershorit 1944. Në këtë fazë ndodh dërgimi i përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ të Shqipërisë në Bari në Shtabin aleat të Mesdheut dhe njohja e ushtrisë Nacionalçlirimtare si forca e vetme që luftonte kundër pushtesve gjermanë. Në fazën e fundit UNÇ nis mësymjen e përgjithshme për çlirimin e Shqipërisë: operacioni për çlirimin e Tiranës (29.10-17.11.1944) e të Shkodrës (23-29 nëntor 1944).

Ajo që kish ndodhur në prill 1939, indiferenca ndërkombëtare ndaj pushtimit italian të Shqipërisë, kish marrë fund: në tribunën e festës së çlirimit të Tiranës, më 28 nëntor 1944, krahas liderëve shqiptarë të LANÇ-it ishin edhe përfaqësuesit ushtarakë të Fuqive të Mëdha aleate, SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit sovjetik; gjashtë avionë britanikë fluturonin mbi Tiranë dhe flamuri amerikan valëvitej lirisht krahas atij shqiptar. Ish një situatë krejt tjetër, po dhe një Shqipëri tjetër, të cilën e ngriti dhe e nxori në dritë pikërisht Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

BOROVA, FSHATI MARTIR KU DHIMBJA PREK ÇDO GUR

Më 6 korrik 1943, rreth orës 15:45, (në Historinë e LANÇ-it jepet ora 13:30) pak kohë pasi forcat e Regjimentit 98, konkretisht kompanitë 11, 12 dhe 13, kishin kaluar Borovën, kolona ra në Barmash në një pritë të ngritur nga batalioni partizan “Tomori”. Me shumë gjasa, siç e pohon edhe Historia e LANÇ-it, partizanët ishin përgatitur të luftonin kundër italianëve. Kur papritmas u dukën gjermanët. Luftimet vazhduan deri në mbrëmje dhe kompanitë gjermane, me mbështetjen edhe të një njësie italiane, arritën të stabilizojnë situatën duke detyruar partizanët të ngrinin pritën dhe të tërhiqeshin në male. Gjithsesi, luftimet disa orëshe tregojnë një betejë të ashpër dhe tërheqja e partizanëve nuk është vetëm pasojë e presionit të forcave të stërvitura gjermane, por shpjegohet edhe me taktikën e luftës partizane. Pas betejës, tre kompanitë gjermane të sipërpërmendura u kthyen në Borovë dhe kryen masakrën e radhës. Ata vranë dhe dogjën të gjallë 107 civilë, prej tyre 64 gra

MASAKRA E BOROVËS, 6 KORRIK 1943

dhe 43 burra, pa kursyer edhe fëmijët e vegjël. Viktima më e vogël ishte 4 muajsh dhe më i vjetri 84 vjeç. Ushtarët gjermanë kalonin shtëpi më shtëpi dhe i vinin flakën gjithçkaje. Po ashtu ata qëllonin çdo njeri që hasnin në rrugë. Në ato shtëpi, ku banorët mbyllën dyert, për të mos i lejuar ushtarët të hynin brenda, gjermanët i vunë flakën shtëpisë, duke e djegur së bashku me njerëzit brenda.

Ishte ngjarje e përmasave jashtë arsyes njerëzore. Ajo masakër e shekullit, që ndodhi 79 vjet më parë, nuk e ka përgjurmur asnjëherë kujtesën historike, ndaj dhimbja nuk pushon. Dhe jo vetëm e banorëve të Borovës e kolonjarëve, por e gjithë shqiptarëve edhe më tej...

Kur vite më parë, në Borovë, erdhi i biri i njerit prej ushtarakëve madhorë nazistë që drejtonin ushtrinë gjermane në Ballkan e Shqipëri,

qëndroi i tronditur ballë për ballë varrezave të 107 viktimave të Borovës që ende dukej sikur nga poshtë dheut e gërmadhave ku dergjen eshtrash, dëgjoheshin zërat e fëmijëve, që hidheshin pa mëshirë në zjarr, të gjallë, dëgjoheshin klithmat e nënave, që esesët u çanin barkun me bajonetë dhe u nxirnin foshnjat...

Dhe pati kurajën e madhe qytetare, ai, i biri i nazistit, t’i kërkojë ndjesë popullit të Borovës, popullit të Shqipërisë.

Dhe pati guximin të përulej përpara varreve të 107-të të vrarëve të asaj dite, ndoshta edhe nga babai i tij, e të vinte një tufë me lule në shenjë kujtimi e pendimi. Dhe u çuditën të gjithë kur ai u përlet.

“Nuk e dija, – iu drejtua borovarëve, – që babai im ka marrë pjesë në një masakër të tillë. E lexova rastësisht në ditarin e tij. Ai nuk jeton

më. Erdha t’ju kërkoj ndjesë për atë çka bërë babai im”!

Në Borovë, vetëm 6 kilometra nga Erseka e ku jetojnë fare pak familje, bie në sy kodra ku ndodhen varrezat e martirëve e ku udhëtimi apo vizitori kureshtar ndalon e mëson historinë. Dikur ajo ka qenë një lagje e fshatit e shkruar plotësisht nga nazistët. Një pjesë e memorialit e konceptuar si një shqiponjë e madhe, që mbron bijtë e saj, kjo varrezë është një objekt historik ku vizitohet nga plot njerëz që duan të dinë historinë dhe çfarë u bë më pas me Borovën. Borova ka qenë një fshat, me njerëz të shkolluar e që emigrimin e patën prekur herët, një fshat që nuk u shua, siç thonë banorët, as nga gjermanët, duke ruajtur traditat dhe cilësitë më të mira.

Përfaqësuesja e FA, **Luiza Gega** i dhuron medaljen e artë Shqipërisë në Lojërat Mesdhetare “Oran 2022”

Atletja shqiptare, Luiza Gega fitoi medaljen e artë në garën e 3 000 metrave me pengesa, me kohën 9'14"31, që gjithashtu është edhe një rekord i ri kombëtar. Atletja kuqezi, Luiza Gega bëri një garë të shkëlqyer. Qysh në start ajo e udhëhoqi garën, duke mos e vënë asnjëherë në dyshim fitoren e saj. Madje nga xhiro në xhiro, ajo e thelloi distancën nga ndjekëset e saj, duke i lënë pas thuajse 50 metra. Fitorja e medaljes së artë në Lojërat Mesdhetare të Oranit në Algjeri, nga atletja Luiza Gega, as më pak dhe as më shumë, është një konfirmim i aftësive të saj sportive, e cila edhe para katër vitesh fitoi medaljen e artë në Lojërat Mesdhetare të Tarragonës në Spanjë.

